

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6105
E premtë, 4 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Agim Çeku ftoshet nga Gjykata Speciale si i dyshuar. FAQE 3



KA FILLUAR RAUNDI I PARË I BISEDIMEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË NË UASHINGTON FAQE 4-5

PËRBALLJE E 'NXEHTË' NË SHTËPINË E BARDHË NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



Me prite pozitive ka filluar takimi i shumëpritur në Shtëpinë e Bardhë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë në kuadër të fazës finale të dialogut për normalizim të marrëd-

hënieve. Kryeministri Avdullah Hoti para takimit ka thënë se me Serbinë do të diskutohet vetëm për njohje reciproke. Ai ka treguar se pritet janë për një marrëveshje ekonomike, e cila do të jetë një

hap drejt njohjes reciproke. Edhe i dërguari i posaçëm amerikan për këtë proces, Richard Grenell, ka treguar se fokusi do të jetë të normalizimi i raporteve ekonomike në mes të dy vendeve



Kuçi paralajmëron se do të ketë mbikëqyrje të rreptë për hidrocentralet. FAQE 7

Gjykata Speciale miraton Rregulloren e Ndihmës Juridike. FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

044/256-051
044/367-061
028/532-617
Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

DO TË BËJ ÇMOS PËR TA MBËSHTETUR KOSOVËN NË RRUGËN E SAJ EVROPIANE F. 11

Shkruan: Tomas SZUNYOG



AKTUALE

ALI AHMETI PËRFUNDOI INTERVISTIMIN NGA GJYKATA SPECIALE F. 2

THEMELOHET PLATFORMA E SHOQËRISË CIVILE PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI F. 3

BIE NUMRI I TË INFETUARVE ME COVID NË KOSOVË, 78 RASTE TË REJA PËR 24 ORË F. 6



EKONOMI

MBI 6 000 VIZITORË GJATË QERSHORIT QËNDRUAN NË KOSOVË F. 8

KURTI NË BISËDË ME PROFESORIN CHANG: TËRHEQJA E KURSIMVE NGA TRUSTI, E RREZIKSHME F. 8

SPORT

PËRTESHI: BASHKIMI NUK NDALET, SYNON SUKSESE EDHE NË EDICIONIN E RI F. 18

Ali Ahmeti përfundoi intervistimin nga Gjykata Speciale

SHKUP, 3 SHTATOR - Zyrtari i lartë i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), aktualisht zëvendëskryeministër i parë në Qeverinë e

Maqedonisë, Artan Grubi, ka bërë me dije se kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka përfunduar intervistimin dydorë pranë Prokurorisë Speciale të Kosovës në Hagë.

Kosovës në Hagë. "Kryetari Ahmeti sapo e përfundoi intervistimin dydorë pranë Prokurorisë Speciale të Kosovës në cilësinë e dësh-

mitarit si themelues i UÇK-së dhe LPK-së dhe kthehet në Maqedoni", ka shkruar Grubi në llogarinë e vet në "Facebook".



Gjukanoviqi thotë se partia e tij është e gatshme të shkojë në opozitë

PODGORICË, 3 SHTATOR - Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviq, ka thënë se Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) është e gatshme të jetë partia më e fortë e opozitës dhe se, si president, ai do t'u përbahet kompetencave të tij kushtetuese kur bëhet fjalë për qeverinë e re.

Në një intervistë për televizionin austriak ORF, ai ka theksuar se partia e tij pranoi rezultatet paraprake të zgjedhjeve dhe se nuk presin që ato përfundimtare të janë të ndryshme. "Formimi i qeverisë, siç e dini, është një punë që nuk ka filluar ende. Ne do të shohim nëse ky koalicion me tre anëtarë, i cili fitoi 41 vende, mund të arrijë vërtet një nivel të tillë afërsie të programeve dhe politikave për të formuar një qeveri dhe për ta marrë përsipër përgjegjësinë e pushtetit ekzekutiv në Malin e Zi", ka thënë ai.



Gjukanoviqi ka thënë se sot, "siç mund ta shohim, projekti

kombëtar i Serbisë së Madhe është ringjallur". "Ky projekt

pretendon t'i sigurojë Serbisë disa kompensime për humbjen

e Kosovës dhe natyrisht që Mali i Zi është synimi i parë i nacionalizmit serb. Supozoj se të gjithë e kuptojmë këtë, askush nuk është i painformuar", ka thënë ai.

Të dielën në Mal të Zi u mbajtën zgjedhjet parlamentare, në të cilat për herë të parë pas tri dekadash Partia Demokratike e Socialistëve e presidentit Millo Gjukanoviq ka humbur.

Zgjedhjet u fituan nga partitë opositarë që konsiderohen si pro-serbe dhe pro-ruse.

Mali i Zi, përndryshe, konsiderohet lider në procesin e integrimit evropian. Ai ka qenë vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që ka nisur negociatat e pranimit me Bashkimin Evropian në qershor të vitit 2012.

Më 2 shtator kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, deklroi se Serbia në asnjë mënyrë nuk ndërhyr në punët e brendshme të Malit të Zi.

Shteteve amerikane u kërkohet të përgatiten për shpërndarje të vaksinës për Covid-19 nga nëntori

NUJ JORK, 3 SHTATOR - Zyrtarët amerikanë u kanë thënë shteteve që të janë gati për shpërndarje të vaksinës potenciale për koronavirus nga 1 nëntori, duke ngritur shqetësimin se administrata e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, është duke përspejtuar këtë proces para zgjedhjeve të 3 nentorit.

Qeveritë në gjithë botën janë duke shpresuar se do të gjiejë dhe shpërndajnë vaksinën sa më shpejt që është mundur, në mënyrë që ta rihapin ekonominë, ndërkohë që koronavirusi ka infektuar 25

milionë persona, prej tyre 850 000 kanë vdekur.

Në Shtetet e Bashkuara presidenti Trump ka thënë se vaksina mund të arrijë edhe para fundit të vitit, ndonëse shumë ekspertë shëndetësorë kanë dilema nëse mund të planifikohen të gjitha testimet klinike brenda një kohe aq të shkurtër.

Në një letër drejtuar shteteve dhe disa qeverive lokale, Qendra për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve ka kerkuar që të hiqen pengesat burokratike dhe të bëhen përgatitet për shpërndarje të vaksinës potenciale.



Anthony Fauci, zyrtari më i lartë amerikan për sëmundje

në fund të këtij viti kalendarik ne do të jemi rehat që kemi një vaksinë të sigurt dhe efektive". Sipas së përditshmes amerikane "The New York Times", prioritet për vaksinim do të kenë punëtorët shëndetësorë, zyrtarët për siguri kombëtare dhe pjesëtarët e grupeve të ndjeshme etnike e racore. Ende asnjë vaksinë nuk ka rezultuar e sigurt dhe efektive për koronavirus, ndonëse tri kompani perëndimore janë duke përparruar drejt fazës së tretë të testimeve klinike. Sipas procedurave normale, verifikimi i vaksinave potenciale merr disa muaj.

Shqipëria, e treta në Evropë për vrasjet në raport me popullsinë

TIRANE, 3 SHTATOR - Shqipëria renditet e treta në Evropë për nivelin më të lartë të viktimate nga vrasjet në raport me popullsinë, pas Latvisë dhe Lituanisë, sipas të dhë-

nave të Eurostat-it dhe INSTAT-it, që i referohen vitit 2017.

Në 2017-n, sipas INSTAT-it, në Shqipëri kishte gjithsej 68 viktima nga vrasjet, nga të cilët 56

ishin meshkuj dhe 12 ishin femra. Në raport me popullsinë e atij viti, të publikuar nga INSTAT, llogariten 2.36 vrasje për 100 mijë banorë. Në Shqipëri numri më i lartë i

viktimate nga vrasjet në pesë vjetët e fundit është shënuar në 2016-n, me 99 humbje jete, duke zbritur në 68, përkatësisht në 2017-n dhe 2018-n.



Themelohet platforma e shoqërisë civile për dialogun Kosovë - Serbi

Përfaqësues të shoqërisë civile - me ekspertizë në fushën e dialogut Kosovë - Serbi - janë bërë bashkë për të themeluar një platformë të përbashkët me qëllim të promovimit të transparencës, llogaridhënieve dhe gjithëpërfshirjes në dialogun Kosovë - Serbi. Platforma e Shoqërisë Civile për Dialog synon të ushtrojë një rol më proaktiv dhe të organizuar, duke u kthyer në faktor më me ndikim në procesin e dialogut dhe atë të normalizimit

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRIŞHTINË, 3 SHTATOR

Përfaqësuesit e trembëdhjetë organizatave të shoqërisë civile kanë vendosur të krijojnë një platformë të përbashkët të bashkëveprimit dhe koordinimit të OJQ-ve në Kosovë, të cilat kanë zhvilluar dhe zhvillojnë ekspertizë në fushën e dialogut Kosovë - Serbi. Sipas këtyre organizatave, dialogu Kosovë - Serbi është një ndër proceset më të rëndësishme të konsolidimit të shtetit të Kosovës dhe avancimit të orientimit të saj euroatlantik. Këto organizata të shoqërisë civile theksojnë se normalizimi i marredhënieve Kosovë - Serbi, si një proces afatgjatë, që shkon përtjerë arritje së marrëveshjeve në mes palëve, kërkon ndërtimin e konsensusit politik dhe atij shoqëror si pikënisje drejt arritje së çfarëdo rezultati në këtë drejtim.

Përfaqësuesit e trembëdhjetë organizatave të shoqërisë civile thonë se, përkundër rifillimit të këtij procesi nën një mandat të ri të

Përfaqësuesit të Lartë të BE-së dhe me përfshirjen e ShBA-së, mungesa e transparencës, llogaridhënieve dhe konsensusit politik vazhdon ta karakterizojë të njëtin. Në kuadër të zhvillimeve aktuale dhe atyre që priten në të ardhmen, një rol i koordinuar, i harmonizuar dhe i përbashkët i përfaqësuesve të shoqërisë civile, mbetet i rëndësishëm për të shërbyer si katalizator i procesit. "Njëkohësisht, një avokim i

përbashkët brenda dhe jashtë vendit, përmes veprimeve që synojnë ndikim pozitiv në proces të dialogut, është më se



ORGANIZATAT THEMELUËSE TË PLATFORMËS:

Demokracia për Zhvillim (D4D)
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)
Fondi për të Drejtën Humanitare (HLC)
Iniciativa e Re Sociale (NSI)
Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)
Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS)
Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillimeve të Politikave (KIPRED)
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR)
OJQ 'Aktiv'
OJQ Mundësia (MDA)
Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)
S'BUNKER
Donika Emini

i nevojshëm. Prandaj, përfaqësuesit e shoqërisë civile të poshtëcekura vendosin të krijojnë një platformë të përbashkët të bashkëveprimit dhe koordinimit të OJQ-ve në Kosovë, të cilat kanë zhvilluar dhe zhvillojnë ekspertizë në fushën e dialogut Kosovë - Serbi. Me qëllim të promovimit të transparencës, llogaridhënieve dhe gjithëpërfshirjes, përfaqësuesit e shoqërisë civile synojnë të ushtrojnë një rol më proaktiv dhe të organizuar, duke u kthyer në faktor më me ndikim në procesin e dialogut dhe atë të normalizimit", theksohet në komunikatën e përbashkët të këtyre organizatave të shoqërisë civile. Po në këtë komunikatë theksohet se, duke synuar

paanshmëri në proces, anëtarët e kësaj platforme kanë për qëllim të kontribuojnë në proces me anë të veprimeve të përbashkëta, mbi bazën e ekspertizës së tyre, por duke mos u bërë pjesë e ekipeve politike në kuadër të dialogut. "Anëtarët nënshkrues synojnë të promovojnë një dialog publik të strukturuar dhe konstruktiv lidhur me procesin e dialogut dhe temat që ndërlidhen me të. Përbrenda funksionimit të platformës ato synojnë afrimin dhe njoftimin e qytetarit me procesin e dialogut, duke avokuar për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit në këtë proces me aktorë të brendshëm dhe ndërkombëtarë", thuhet në komunikatën për media.

Mbi 29 mijë të akuzuar gjatë vitit 2019 në Kosovë

PRIŞHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e jurisprudencës për persona madhorë" për vitin 2019. Ky publikim ofron të dhëna statistikore për personat madhorë të akuzuar dhe të dënuar për vepra penale në vitin 2019. Të dhënat për personat madhorë ofrohen sipas gjinisë, nacionalitetit të kryerësit të veprës penale, sipas mënyrës së zgjidhjes së aktakuzës, paraqitësit të aktakuzës dhe llojit të dënimit, të shqiptuar për kryerësit e veprave penale. Sipas rezultateve të dala nga ky


publikim, në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në vitin 2019 ishin të akuzuar 29 405 persona madhorë. Numri më i madh i të akuzuarve ishte në Gjykatën Themelore të Prishtinës me gjithsej 5 954 persona, ose 20.2 për qind e numrit të përgjithshëm.

Nga gjithsej 29 405 persona të akuzuar, janë dënuar 17 315 prej tyre, ose 58.9 për qind e të akuzuarve. Numri më i madh i të dënuarve ishte, po ashtu, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, me gjithsej 2 757 persona, ose 15.9 për qind e numrit të përgjithshëm.



KA FILLUAR RAUNDI I PARË I BISEDIMEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË NË UASHINGTON

PËRBALLJE E 'NXEHTË' NË SHTËPINË E BARDHË



Me pritje pozitive ka filluar takimi i shumëpritur në Shtëpinë e Bardhë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë në kuadër të fazës finale të dialogut për normalizim të marrëdhënieve. Kryeministri Avdullah Hoti para takimit ka thënë se me Serbinë do të diskutohet vetëm për njohje reciproke. Ai ka treguar se pritet janë për një marrëveshje ekonomike, e cila do të jetë një hap drejt njohjes reciproke. Edhe i dërguari i posaçëm amerikan për këtë proces, Richard Grenell, ka treguar se fokusi do të jetë te normalizimi i raporteve ekonomike në mes të dy vendave

**EPOKA
ERE** Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kosova dhe Serbia kanë filluar përballjen finale për normalizim të marrëdhënieve në Shtëpinë e Bardhë. Palët kanë shprehur optimizëm për rezultatet e këtij takimi.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, para takimit ka thënë se pritet janë për arritjen e një marrëveshje përbashkëpuni të ekonomik, e cila do të jetë një hap më afér normalizimit përfundimtar të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. "Sot fillojmë me shumë pozitivitet takimin në

Shtëpinë e Bardhë bashkë me delegacionin për t'i diskutuar projektet e zhvillimit ekonomik mes të dyja vendave. Pritjet i kemi jashtëzakonisht pozitive me komunikimet që kemi pasur deri më tash", ka thënë Hoti para gazetarëve. Ai ka deklaruar se me Serbinë nuk mund të bëhet asnjë diskutim tjetër përvèç për njohje reciproke. "Asnjë diskutim tjetër nuk bëhet me Serbinë përvèçse për njohje reciproke. Unë besoj se marrëveshja e sotme që mund të arrihet për bashkëpuni të ekonomik është një hap më afér normalizimit përfundimtar

marrëdhënieve mes dy vendave që është vetëm njohja reciproke", ka thënë kryeministri Hoti.

Edhe i dërguari i posaçëm i administratës së Trumpit për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka bëre thirrje për një normalizim ekonomik në mes të dy vendave. Para takimit, ai i ka ftuar palët që të mendojnë për të rinxjtë dhe ta lënë anash politikën. "Qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë meritojnë normalizim ekonomik dhe mundësi të krijojnë një ekonomi të gjallërishme. Sot jam i përqendruar te të rinxjtë që duan një karrierë, një punë të mirë dhe një lidhje me Perëndimin. Ju kam dëgjuar. Do të mundohem fort për ju. Ta lëmë anash politikën", ka shkruar Richard Grenell në llogarinë e vet në "Twitter".

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili nuk do të jetë pjesë e këtij takimi, ka kërkuar nga delegacioni i Kosovës të bëjë hapët të guximshëm në Uashington. "U duartrokas udhëheqësit të Shtëpisë së Bardhë, presidentit Donald Trump dhe ambasadorit Richard Grenell, për t'i sjellë përsëri së bashku Kosovën dhe Serbinë në kërkim të një marrëveshje përpajse. E nxis delegacionin e

Kosovës për të bërë hapët të guximshëm drejt paqes, pajtimit dhe prosperitet ekonomik", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter". Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm këtë takim. Ajo ka deklaruar përgazetën "Epoka e re" se në këtë takim do të shënohen hapë përpëra drejt njohjes reciproke në mes të dy shteteve. "Ky takim do të shënojë hapë përpëra drejt njohjes reciproke mes dy shteteve, por nuk pres përmbyllje të marrëveshjes. Është folur zyrtarisht se do të jetë agjendë ekonomike, mirëpo unë besoj se nuk mund t'i shmanget temave të tjera, sepse gjërat janë të ndërlidhura dhe në Ballkan është vështirë të ndahen temat ekonomike nga ato politike, apo gjeopolitike", ka thënë Tahiri.

Ajo ka treguar se nga ky takim mund të pritet arritura e ndonjë marrëveshje ekonomike. Sipas Tahirit, marrëveshjet ekonomike duhet të kenë kornizë të qartë politike. "Nëse do të ketë marrëveshje ekonomike, ajo marrëveshje duhet të ketë kornizë të qartë politike. Pra, të jetë marrëveshje mes dy shteteve të pavarrura dhe sovrane. Këtë po

e theksoj, sepse nëse do të kemi një marrëveshje vetëm ekonomike, pa aspektin bilateral shtetëror, atëherë do të ishte një marrëveshje e cila do ta cenonte shtetësinë e Kosovës", është shprehur Tahiri.

Opozita kritikon delegacionin e Kosovës

Dy subjektit opositare, LV-ja dhe PDK-ja, kanë kritikuara delegacionin e Kosovës i cili ka filluar raundin e parë të bisedimeve me Serbinë në Shtëpinë e Bardhë. Lideri i LV-së, Albin Kurti, e ka quajtur turizëm qeveritar vizitën e delegacionit të Qeverisë së Kosovës në Uashington për takimin me Serbinë. Në një konferencë për media, Kurti ka thënë se ekipi i Kosovës nuk është i koordinuar. "Delegacioni e Kosovës shkoi tri ditë më herët, para fillimit të bisedimeve. Ky është turizëm qeveritar me para të shtetit e të popullit. Delegacioni nga Kosova është enorm për nga numri i pjesëmarrësve dhe shumëfish më i madh sesa ai nga Serbia. S'ka përvojë në negociata ndërkombëtare, por vetëm në ato për poste qeveritare. Mbështetat e vërteta janë mes ShBA-së dhe

RDHË NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



Serbisë, e delegacioni kosovar eshtë ndërmjetësues i panevojshëm", ka thënë Kurti. Ai sërish ka kritikuar të dërguarin e posaçëm të administratës së Trumpit për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell, duke thënë se atij po i ngutet një marrëveshje e shpejtë ndërmjet Kosovës

dhe Serbisë. "Ndërmjetësi në çdo negociatë konsideron se pala eshtë racionale dhe mbron interesat nacionale. Ndërmjetësi do marrëveshje, aq më tepër Grenelli që i ngutet, e kur i ngutet ai bën trysni në palën më të dobët", ka deklaruar Kurti, duke thënë se nuk mund të ketë marrëveshje

ekonomike me Serbinë pa marrëveshje politike. Edhe PDK-ja ka kritikuar përbërjen e delegacionit qeveritar. Deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se delegacioni i Kosovës nuk ka përvjetorë për negociata dhe as

ekspertë nga fusha e negocimit. "Përbërja e delegacionit e Kosovës ishte e madhe dhe shpresoj se do të shërbejë për ta ndihmuar kryeministrin në vendimet që do të merren. Mendoj se delegacioni i Kosovës do të duhej të përfaqësohej edhe me ekspertë me përvjetorë politike

dhe diplomatike. Kosova nuk ka kohë të humbë në çdo periudhë të dialogut e sidomos kur tani ky proces është duke u konsideruar përfundimtar", është shprehur ajo.

Musliu-Shoshi ka vlerësuar se në këtë proces PDK-ja do ta ushtronjë rolin e saj kushtetues në Kuvendin e Kosovës. "Për ne është e rëndësishme marrëveshja që do të sjellë përmiratim në Kuvend, e cila për ne duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare që është në përputhje me platformën tashmë të njojur të saj, e cila garanton njojen e ndërsjellë, sovranitetin shtetëror, integritetin territorial, karakterin unitar të shtetit dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB", ka thënë ajo. Nikoqirë të takimit do të janë këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, Robert O'Brien, si dhe i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë-Serbi, Richard Grenell. Takimi në Shtëpinë e Bardhë midis Kosovës dhe Serbisë është i dyti i tillë i thirrur nga Washingtoni. Takimi i planifikuar më 27 qershor është anuluar pak ditë para mbajtjes, pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë ka njoftuar se ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ka qenë i ftuar në takimin e Washingtonit.

Pas takimit në Shtëpinë e Bardhë, kryeministri Hoti dhe presidenti Vuçiq do të takohen në Bruksel të hënën, ndërsa gjatë kësaj fundjave do të zhvillohen bisedime në nivel të ekspertëve.

Gjkata Speciale miraton Rregulloren e Ndihmës Juridike

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) me seli në Hagë njoftuan se është miratuar Rregullorja e Ndihmës Juridike. Ky dokument u mundëson të dyshuarve ose të akuzuarve, të cilët dëshmojnë se nuk janë në gjendje të paguajnë përmbrrojtjen e tyre dhe nuk marrin ndihmë juridike në mënyra të tjera, të përfitojnë ndihmë juridike të plotë ose të pjesshme përmbrrojtjen e pagesën e avokatit që zgjedhin vetë dhe i cili plotëson kushtet e pranimit në listën e mbrojtësve të DHSK-së. Në komunikatën e Dhomave të Specializuara thuhet se administratorja Fidelma Donlon miratoi Rregulloren e Ndihmës

Juridike në Dhomat e Specializuara të Kosovës, e cila pasqyron praktikat më të mira të standardeve të ndihmës juridike, duke garantuar respektimin e parimeve të gjykimit të drejtës. "Ndihma juridike mbulon pagesën e mbrojtësit dhe anëtarëve të ekspertëve mbrojtësit dhe i paguhet drejtësia mbrojtësit", thuhet në komunikatë. Kryetarja e Dhomave, Ekaterina Trendafilova, e përshtështë miratimin e Rregullores, duke theksuar se ky dokument "ngërthen parimet themelore të parapara në ligjin tonë dhe standartet universale në drejtësinë penale, duke garantuar të drejtën e të akuzuarve përgjim të drejtë

që përfshin edhe të drejtën pëmbrojtje efektive". Të gjithë personave që u paraqitet nevoja për ta shfrytëzuar këtë mundësi duhet të bashkëngjitet edhe deklarimin e mjeteve financiare. "Zyra e Mbrojtjes kryen një verifikim rrënjosur të mjeteve financiare të parashtruesit të kërkësës përtë përcaktuar nëse duhet miratuar ndihmë juridike e plotë ose e pjesshme. Kërkësë për ndihmë juridike refuzohet nëse parashtruesi i kërkësës nuk bashkëpunon ose jep informacion të rremë", thuhet në komunikatë. Gjkata Speciale, me emrin Dhomat e Specializuara, funksionon me ligje të Kosovës, por selinë e ka në Hagë.



Bie numri i të infektuarve me Covid në Kosovë, 78 raste të reja për 24 orë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) janë testuar gjithsej 459 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 78 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar edhe nëntë raste të vdekjes, ndërkaq janë shëruar edhe 190 pacientë.

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Institucionet shëndetësore në Kosovë kanë njoftuar të enjten se nga Covid-19 kanë vdekur edhe nëntë persona. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar edhe 78 persona të infektuar me Covid-19. Rezultati është në bazë të 459 testimeve të kryera. Aktualisht raste aktive me Covid-19 në Kosovë janë 3 130. IKShPK-ja ka njoftuar se nga Covid-19 janë shëruar edhe 190 pacientë.

Bazuar në të gjitha këto të dhëna, që nga fillimi i pandemisë në muajin mars, në Kosovë janë regjistruar 13 791 të infektuar me Covid-19. Prej këtyre, 548 kanë vdekur, ndërsa 10 113 janë shëruar.

Shërbimi Spitalor dhe Klinik

Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të enjten se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 426 pacientë, prej tyre 313 janë të prekur me koronavirus. Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se tetë pacientë janë në respiratorë, 24 janë duke u trajtuar me makinat e frysëmarrjes CPAP, derisa 287 të tjerë janë në oksigenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.

Ministria e Shëndetësisë në Kosovë ka njoftuar se të enjten ka licencuar edhe pesë laboratorë të tjerë për kryerje të testeve për Covid-19. Prej këtyre, dy do të mund të kryejnë teste virologjike, nëpërmjet të cilëve një person kupton nëse është i infektuar me Covid-19 në kohën kur



Nga këto komuna janë rastet e fundit me Covid-19

Rastet pozitive me Covid-19 gjatë 24 orëve të fundit janë nga: komuna Prishtinë 29 raste, komuna Prizren 7 raste, komuna Ferizaj 6 raste, komuna Deçan 5 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Malishevë 3 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Hani i Elezit 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste dhe komuna Suharekë 2 raste.

testohet.

Tre laboratorë të tjerë do të kryejnë teste serologjike, nëpërmjet të cilëve kuptohet nëse një persona ka pasur në të kaluarën këtë virus. Deri më tanë në Kosovë janë licencuar edhe 118 laboratorë të tjerë, kurse vetëm një prej tyre ka kryer teste virologjike.

Zemaj: Së shpejti do të angazhohen edhe 375 profesionistë shëndetësorë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, së bashku me drejtoret e klinikave të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës/ShSKUK, kanë trajtuar situatën epidemiologjike, rritjen e kapaciteteve, planifikimin e objektivave dhe aktivitetave, furnizimet, si dhe hollësi të tjerë rrëth punës në secilën klinikë. Ai ka thënë se MSh-ja si institucion politikë, rregulator dhe mbikëqyrës i sektorit të shëndetësisë vazhdimisht po përpinqet t'i rrisë kapacitetet për t'i përmirësuar cilësinë, sasinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore. "Jemi të gatshëm të ballafaqohemi me cdo skenar. Së fundi, kemi mobilizuar kapacitet e disa klinikave, si ndihmë për



Krasniqi falënderon zyrtarët e OBSh-së përkrahjen e vazhdueshme

Prishtinë, 3 shtator (ER) - Ushtruesi i detyrës i drejtitorit të përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, Valbon Krasniqi, ka pritur në takim pune zyrtarë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Gjatë takimit

drejtori Krasniqi i ka informuar zyrtarët e OBSh-së në lidhje me punën dhe aktivitetet e ShSKUK-së, duke theksuar punën dhe përkushtimin e profesionistëve shëndetësorë përmenaxhimin e situatës me Covid-19. Ai ka falënderuar

zyrtarët e OBSh-së përkrahjen e vazhdueshme, duke kërkuar mbështetjen e mëtejme. Gjatë takimit, zyrtarët e OBSh-së u interesuan përsituatën aktuale në ShSKUK, duke ofruar edhe më tutje përkrahjen e tyre.



Agim Çeku ftohet nga Gjykata Speciale si i dyshuar

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës dhe ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Agim Çeku, është ftuar në Hagë për intervistim nga Gjykata Speciale për Krimet e Luftës (Dhomat e Specializuar) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar). Ai është ftuar në cilësinë e të dyshuarit, ndërkaq intervistimi nga ana e prokurorëve është caktuar për datën 28 shtator.

Çeku ka qenë edhe zëvendësministër i Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ai ishte pjesëmarrës në luftërat në

Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Gjykata Speciale në Hagë po heton krimet e pretenduara nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë nga janari 1998 deri në dhjetor 2000, të cilat përmenden në raportin e Këshillit të Evropës 2011. Autori i raportit është ish-senatori zviceran Dick Marty. Ish-anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë marrë në pyetje nga Prokuroria e Hagës që nga janari 2019, si të dyshuar ose si dëshmitarë. Deri më tani presidenti aktual

Hashim Thaçi, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, ish-kryetari i Kuvendit Kadri Veseli dhe ish-udhëheqës të tjerë të UÇK-së, përfshirë Azem Syla, Sami Lushtaku, Rrustem Mustafa, Shukri Buja etj. janë ftuar për intervistim. Aktakuzat e para u paraqiten në gjykatë në shkurt, pastaj në prill. Aktakuza kundër presidentit të Kosovës, Thaçi, e cila u paraqit në prill, aktualisht është duke u shqyrtau. Deri më tani asnjë aktakuzë nuk është konfirmuar ose hedhur poshtë publikisht. Gjyqtari ka gjashtë muaj për ta konfirmuar ose hedhur poshtë aktakuzën.



Veseli në Vushtrri dhe Mitrovicë: Kosova është një e pandashme



VUSHTRRI/MITROVICË, 3 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i shoqëruar nga anëtarë të Kryesisë Qendrore, ka takuar strukturat e partisë në Vushtrri dhe Mitrovicë. Në këto takime Veseli ka folur për situatën politike nëpër të cilën po kalon Kosova si dhe sfidat me pandeminë. Veseli siguroi edhe një herë strukturat e këtyre dy qyteteve se asnjë marrëveshje përfundimtare me Serbinë e cila cenon integritetin territorial të Kosovës nuk do të jetë e pranueshme. "Mitrovica dhe Kosova janë një dhe të pan-

dashme. Asnjë centimetër tokë e Republikës së Kosovës nuk guxon të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë", ka thënë kryetari Veseli. Veseli ka shprehur mbështetjen e tij dhe të partisë për këto dy degë dhe ka inkurajuar ato që ta vazhdojnë punën e mirë në të mirë të qytetarëve të këtyre dy komunave. Kryetarët e degëve të Vushtrrisë dhe të Mitrovicës, Kurtan Kajtazi dhe Bedri Hamza, kanë falënderuar kryetarin Veseli për mbështetjen dhe janë zotuar se puna e tyre në interes të qytetarëve do të jetë fokus kryesor edhe më tutje.

Gjenden mbetje mortore gjatë gërmimeve në Mitrovicën e Veriut

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Autoritetet e Kosovës konfirmuan se gjatë gërmimeve në brendësi të hapësirës së varrezave të komunitetit mysliman në Mitrovicë të Veriut të enjten janë gjetur mbetjet mortore të së paku një personi, që dyshohet se është viktimi e luftës së fundit në Kosovë. "Në rastin konkret janë duke u zhvarrosur mbetjet mortore të një viktime të luftës dhe pastaj sigurisht po flas përmirësim. Pastaj do të vazhdohet ekzaminimi ligjor dhe, varësisht prej ekzaminimeve, përfshirë edhe analizën ADN, mund të konfirmohet numri i individëve të zhvarrosur dhe identiteti i tyre", ka dekluaruar Kushtrim Gara nga Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur. Gara ka pohuar se në bazë të informatave të siguruara, në të njëtin vend dyshohet edhe për

pesë raste të tjera. Ai ka shtuar se në vendin ku janë bërë gërmimet janë kthyer për të disatën herë në bazë të disa informacioneve të reja të marra nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe ato të komisionit të pagjeturve në Serbi. "Në ditët në vijim do të kthehem sërisht në këtë lokacion, varësisht prej punës që po e bëjmë në kuptimin e lokalizimit të rasteve", është shprehur Gara.

Autoritetet e Kosovës vit pas viti, që nga përfundimi i luftës, kanë kryer gërmime në lokacione brenda territorit të Kosovës, të dyshuara për varreza masive. Edhe dy dekada pas luftës 1 643 persona vazhdojnë të konsiderohen të zhdukur. Nga ky numër, pjesa më e madhe janë shqiptarë, të tjerët janë serbë dhe pjesëtarë të komuniteteve joshumicë që jetojnë në Kosovë. (Rel)



Mbi 6 000 vizitorë gjatë qershorit qëndruan në Kosovë



PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e hotelerisë në Kosovë" për tremujorin e dytë (TM2) 2020. Sipas ASK-së, në TM2 2020 pjesë e anketës ishin 199 hotele, që ushtronjnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. "Për shkak të pandemisë, me vendim të Qeverisë së Kosovës, hotelet kanë qenë të mbyllura gjatë muajve prill dhe maj 2020. Andaj, të

dhënat e publikuara në këtë tremujor paraqesin rezultatet vetëm të muajit qershor 2020, pasi hotelet kanë filluar të punojnë nga data 1 qershor 2020. Në TM2 2020, numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) ishte 6 831, prej tyre 47.96 për qind janë vendorë dhe 52.07 për qind janë të huaj. Ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 10 466, prej tyre 48.45 për qind nga vendorët dhe 51.55 për qind nga të huajt.

Numrin më të madh të vizitorëve dhe netqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Prishtinës, me 2 439 vizitorë dhe 3 626 netqëndrime", është thënë në raportin e ASK-së, duke u shtuar se numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë e këshu me radhë. "Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh është nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra etj", thuhet në raportin e ASK-së.

Kryeshefja e Postës e njofton ministrin Quni me shërbimet postare



PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka pritur të enjten në takim ushtruesen e detyrës së kryeshefes ekzekutive të Postës

së Kosovës, Vjollca Shala-Mulaj, me bashkëpunëtorë, në vazhdën e takimeve të tyre me bartësit e institucioneve të vendit. Mulaj ka shprehur

falënderimin për pritjen dhe e ka njoftuar ministrin Quni me të arriturat e deritashme dhe sfidat aktuale të Postës së Kosovës. Gjithashtu, ajo e ka njoftuar

edhe me shërbimet postare, veprimtarinë postare dhe të arriturat e filateliç së Kosovës. Nga ana e tij, ministri Quni ka falënderuar Mulajn për

shërbimet e deritashme dhe e ka vlerësuar të nevojshme rritjen e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në temat e interesit të ndërsjellë institucional.

Kurti në bisedë me profesorin Chang: Tërheqja e kursimeve nga Trusti, e rrezikshme

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, pas takimit virtual me profesorin Ha-Joon Chang nga Universiteti i Cambridges, ka thënë se tërheqja e kursimeve nga Fondi Pensional është i rrezikshëm dhe i pakuptimit. Kurti në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se një politikë e tillë do të dështojë të ndihmonte ata qytetarë që kanë më së shumti nevojë përmështetje në këtë kohë të pandemisë Covid-19. Sipas Kurtit, profesori Chang ka propozuar një nismë tjetër përimëkëmbjen ekonomike të Kosovës, përkatësisht

angazhimin e diasporës duke investuar në letra me vlerë. Kurti ka bërë me dije se në këtë takim 90-minutësh është folur përmështetje me të cilat po përballet Kosova.

"Profesor Chang tha se ekziston zgjedhja midis varieteteve të kapitalizmit dhe se nga shtetet e tjera e kohërat e tjera duhet të mësojmë e të mos imitojmë. Një ndër shqetësimet kryesore të ngritura, ka qenë në lidhje me propozimin e qeverisë përtë lejuar tërheqjen e 10 për qind të kontributave nga Trusti pensional i Kosovës. Sipas profesorit Chang, ky propozim është po aq i rrezikshëm sa është edhe i pakuptimit. Sipas vlerësimit të tij, një politikë e tillë jo vetëm se do të dështojë të ndihmonte pikërisht ata qytetarë që kanë më së shumti nevojë përmështetje në këtë kohë pandemie, por edhe do t'i rrezikonte seriozisht kursimet pensionale të brezave të ardhshëm", ka thënë Kurti.



"Profesor Chang tha se ekziston zgjedhja midis varieteteve të kapitalizmit dhe se nga shtetet

Kuçi paralajmëron se do të ketë mbikëqyrje të rreptë për hidrocentralet



Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka thënë se asnjë qeveri deri tani nuk ka marrë vendim për ndaljen e ndërtimit të hidrocentraleve. I ftuar nga Lëvizja Fol për të diskutuar rreth shfuqizimit të vendimit të ministrisë për moratorium në ndërtimin e hidrocentraleve dhe konsultimet me publikun, ai ka thënë se duhet të ketë procedura më të rrepta të mbikëqyrjes së ndërtimeve të hidrocentraleve

më tani.

Panelistë në këtë diskutim ishin ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, anëtar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis, Hadrulla Çeku dhe Eliza Hoxha, kryesuese e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka thënë se baza ligjore për hidrocentralet ka të bëjë me

Ligjin për Ujëra dhe Energjinë si dhe dokumentet që votohen nga qeveria. "Deri më tash nuk kam parë ndonjë vendim nga qeveria për ndaljen e punimeve të hidrocentraleve, përjashto vendimin që ka marrë ish-ministrja e fundit, por që këtë e ka bërë për shkak të pandemisë", ka thënë ai. Kuçi ka bërë me dije se qeveria ka hartuar planin për rishikim të projekteve dhe se do të ketë mbikëqyrje të rreptë. Ai ka mirëpritur themelimin e komisionit hetues nga Kuvendi i Kosovës për këtë çështje. "Kosova ka nxitur prodhimin e energjisë së ripërtërishme, ku hyjnë edhe hidrocentralet. Një defekt që kam parë është se procedurat e rrepta të mbikëqyrjes së këtij procesi nuk janë respektuar sa duhet. Ne jemi duke shikuar që këto procedura të mbikëqyrjes t'i bëjmë më të rrepta", ka thënë ai. Kuçi ka shtuar se nuk mund të ndalet në tërësi procesi i ndërtimit të hidrocentraleve, por ka theksuar se do të ketë ndryshim të strategjisë.

Ai ka vlerësuar se në bazë të lëvizjes së trendëve mund të mos ketë nevojë për prodhimin e energjisë nga hidrocentralet. "Trendët janë duke shkuar që mos të kemi nevojë të energjisë nga uji, por nuk mund ta ndalim në tërësi. Jemi duke shikuar strategjinë dhe së shpejti do të dalim me një vendim", është shprehur ministri Kuçi. Duke folur për rastin në Deçan, ai ka thënë se kjo çështje është në procedurë hetimore dhe ende nuk janë lëshuar lejet e duhura për ta konsideruar këtë çështje të përfunduar.

Ministri Kuçi ka theksuar se në vazhdën e ruajtjes së ambientit, së shpejti në qeveri do ta dërgojnë rregulatorin për Parkun Nacional të Bjeshkëve të Nemuna. "Për planin hapësinor për Bjeshkët e Nemuna kemi diskutim me banorët dhe komunat përreth ku kemi marrë sugjerimet e tyre dhe ne do ta dërgojmë në qeveri rregulatorin për Parkun e Bjeshkëve të Nemuna", u shpreh ministri Kuçi.

Ndërsa deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Hadrulla Çeku, ka thënë se me resurset zhvillimore të Kosovës është abuzuar në vazhdimësi qoftë me zonat urbane në kuptimin e ndërtimit, pastaj edhe me vendet malore. "Ka numër shumë të madh të hidrocentraleve të ndërtuara dhe në ndërtim e sipër dhe nuk ka kontroll mbi punën e tyre. Ka dyshime të panumërtë për shkelje kryesish ligjore procedurale", ka thënë ai. Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se i gjithë investimi i mëhershëm është bërë vetëm në hidrocentrale dhe vonë ka nisur në mënyra të tjera të prodhimit të energjisë alternative. "Është bërë një investim i shpejtë, mos të them i pamatur, ndoshta i pastuduar mirë. Në procesin e licencimit apo dhënes së lejes apo pëlpimeve mjedisore si duket procedurat janë kryer në kuptimin e letrave, por ne sot i shohim që nuk janë të kryera siç duhet", ka thënë deputetja Hoxha.

KEDS-i po ndriçon për herë të parë fshatin Kabash të Prizrenit

PRIZREN, 3 SHTATOR (ER) - KEDS-i është duke përfunduar një projekt të madh investues në Kabash të Prizrenit. Ky fshat historik i shtrirë mbi gërmadhat e lashta arkeologjike, po ndriçojet për herë të parë nga KEDS-i në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit. Ky vendbanim që daton nga lashtësia e që, sipas historianëve, ka qenë i banuar

me popullatë autoktone ilire-dardane, do të kyçet së shpejti në rrjetin energetik të KEDS-it. Investimi, i cili përfshin rreth 60 shtylla betoni, 17 shtylla metalike dhe rreth 6 km largpërçues, pritet të finalizohet brenda këtij viti. Punimet po kryhen me një dinamikë të lartë nga ekipet e KEDS-it. Kjo zonë e thellë malore, e cila parashihet të kthehet në zonë turistike, me

kyçjen në rrjetin energetik të KEDS-it do të ofrojë mundësi të shumta rekreative për qytetarët dhe turistët e huaj. KEDS-i po vazhdon investimet në rrjetin energetik çdo ditë anekënd Kosovës, që tregon përkushtimin e kompanisë përmbytje premtive dhe vendosmërinë për të qenë afër konsumatorit për ta mbështetur aty ku është e nevojshme.



Haziri kërkon vazhdimin e projekteve në Gjilan

GJILAN 3 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në mbledhjen e bordit të drejtoreve ka kërkuar vazhdimin e të gjitha projekteve. Ai ka potencuar se në seancën e radhës të kuvendit të komunës do të propozohet bartja e mjeteve financiare, e gjitha kjo në funksion të realizimit të projekteve kapitale me interes të përgjithshëm.

Kryetari Haziri në këtë mbledhje ka kërkuar angazhim maksimal për përbylljen e plotë të planifikimit vjetor edhe pse në

disa sektorë ka tejkalime të planifikimit falë lojalitetit dhe kulturës së lartë të qytetarëve që t'i paguajnë taksat edhe përkundër që pjesa më e madhe e këtij viti i është përkushtuar parandalimit të pandemisë globale.

Në fushën e arsimit është konfirmuar se janë bërë të gjitha përgatitjet që procesi i mësimit të fillojë në koordinim me Ministrinë e Arsimit, kurse Drejtoria e Shëndetësisë këtë vit kishte sfidë e cila është menaxhuar me kujdes në përballjen me pandeminë globale.

Inspeksioni komunal ka njoftuar për vazhdimin e punës dhe për inspektimin në kuadër të detyrës zyrtare, prej respektimit të masave kundër pandemisë e deri te monitorimi dhe zbatimi i ligjit për sektorë të ndryshëm etj. Edhe në shërbimet publike konfirmohet realizimi i projekteve të kontraktuara në disa vendbanime. Projekte të tjera janë edhe ato në eficiencë të energjisë, në tri shkolla të Gjilanit, të pasuar nga projektet e madhe impiantit dhe kolektorëve e deri te fizibiliteti për Pendën e Livoçit të Epërm.



Përrohet Qendra e Mjekësisë Familjare në fshatin Çifllak të Rahovecit

RAHOVEC, 3 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë dhe bashkëqytetarë, ka bërë të enjten përrurimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Çifllak. Kryetari Latifi ka thënë se çdo projekt që realizohet në të mirë të qytetarëve, i çfarëdo natyre qoftë ai, ka rëndësi të madhe. Ai ka pohuar se projektet në fushën e shëndetësisë janë jetike për qytetarët e Komunës së Rahovecit. "Unë me këtë rast i përgëzoj qytetarët që do t'i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore në këtë objekt dhe i siguroj ata se punëtorët shëndetësorë do të jenë në shërbim të tyre e do të ofrojnë shërbime cilësore", ka thënë Latifi.

Vlera e projektit për ndërtimin e Qendrës së



Mjekësisë Familjare në së Rahovecit i kushtoi 82 996 Çifllak, buxhetit të Komunës euro.

Fillon asfaltimi i rrugës 'Sejdi Kryeziu' në lagjen Pejton

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Të enjten ka filluar asfaltimi i rrugës "Sejdi Kryeziu" në lagjen Pejton për të vazhduar edhe me rrugët "Nazmi Mustafa" e "Perandori Justinian". Lajmin e ka dhënë kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. "Fillimi u siguruam që aty t'ë përfundojë e gjithë infra-

struktura nëntokësore. Në këto rrugë nuk do ta kemi pamjen e vjetër me kabllot e varura të rrymës në gjithë lagjen. Falënderojmë të gjithë qytetarët e lagjes përmirësuarin dhe bashkëpunimin. Tash lagja e tyre do të duket më e bukur, me rend dhe rregull", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



Filloi asfaltimi i dy kilometrave rrugë në Malishevë

MALISHEVË, 3 SHTATOR (ER) - Të enjten ka filluar asfaltimi i një rrugë mbi dy kilometra, e cila fillon në fshatin Carrallukë dhe shkon deri në mes të tokave të punuara në ish-vreshtat. Kjo rrugë ka rëndësi të madhe për bujqit, të cilët kanë plantacionet dhe tokën e punës në këtë pjesë. Kjo rrugë është investim i përbashkët i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Malishevës, e cila është ndërtuar në dy fazë. Në fillimin e asfaltimit të kësaj rruge ishin të pranishëm kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe

drejtori komunal i Urbanizmit, Ahmet Morina, të cilët i kanë uruar pronarët e tokave në këtë pjesë, të cilët prej tanit do ta kenë më të lehtë qasjen në këto prona e që bëhet fjalë për tre mijë hektarë tokë pune. "Investimet në bujqësi dhe krijimi i kushteve sa më të mira për bujqit, me qëllim të punimit të tokës, kanë qenë dhe do të mbeten prioritete tonat. Në mesin e këtyre prioriteteve është edhe hapja e kësaj rruge, qëllim i së cilës është qasja dhe lëvizja më e lehtë për të gjithë bujqit që i kanë pronat në këtë pjesë, ku

dhjetëra pronarë i kanë plantacionet e tyre me perime apo me kultura të lavërtarisë, sidomos të grurit dhe misrit", ka thënë Begaj, i cili ka premtuar se do të vazhdohet përkrahja dhe krijimi i kushteve më të mira për të gjithë bujqit e Komunës së Malishevës.

Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, ka sqaruar se kjo rrugë është e gjatë mbi dy kilometra, e cila me kërkesën e pronarëve të tokave është hapur nga komuna, është punuar baza e saj, ndërsa më pas ministria e bërë asfaltimin e saj.



FENOMENI DRITAN DHE GJUKANOVIQËT E BALLKANIT



Shkruan: Avdi F. SMAJLJA

Është e rrugës që ky reflektim të fillohet me këshillën për Dritanin, se futja në qeveri me partitë pro-serbe në Mal të Zi nënkupton shtyrjen para të objektivave të federatës Ruse në Mal të Zi e Ballkan në përgjithësi. Ajo që dështoi të arrihet përmes puçit të para disa viteve të mbështetur nga Putini, mund t'i hapet rrugë që të realizohet me mjete politike nëse në Mal të Zi krijohet një qeveri pro-serbe. Në mes të fuqizimit të Rusisë në Ballkan përmes një qeverie pro-serbe në Mal të Zi në njérën anë, dhe një qeverie që mundëson vazhdimin e politikave korruptive në krye me Gjukanoviqin në anën tjetër, Dritani do të duhej ta zgjedhte

të dytën, nisur nga parimi i së keqes më të vogël për nga konsekuençat në vend e rajon. Zgjedhjet e fundit në Mal të Zi, sidomos mundësit e koalicionit, ndër të tjera, nxorën në sipërfaqen e opinionit publik në rajon fituesin e zgjedhjeve Dritan Abazoviq. Duke mos e njohur personalisht e as karrierën e tij politike, rezultatet e zgjedhjeve, e sidomos ideologjia dhe partia që i takon në nivel evropian, tregojnë shumë. Partia që ai përfaqëson në nivel evropian i takon partisë më parimore, më demokratike, e më emancipuese në Evropë, the Greens - të Gjelbrit. Rritja e mbështetjes së këtyre vlerave në Mal të Zi, e që do të ishte shumë e nevojshme edhe në vendet e tjera të Ballkanit, tregon për nevojën e ndryshimeve në Mal të Zi e rajon. Ndryshime për të arritur atë që ishte menduar e premtuar në fillim të tranzicionit, e që ende nuk ka përbushur pritet.

Gjukanoviqi në Mal të Zi e Gjukanoviqët e tjerë në vendet e tjera të Ballkanit ishin dhe janë aktorët kryesorë, qoftë për të arritur apo për ngecjet në këto vende. Statistikat, raportet, e studimet tregojnë se në këto vende nuk u arrit ajo që fillimisht u mendua, zhvillimi i vlerave e institucioneve demokratike e liberale. Dhe për këtë të parët që duhet të fajësohen janë Gjukanoviqët e Ballkanit. Tri dekada ngecje në zhvillim të demokracisë e liberalizmit, kanë shndërruar Ballkanin në mundësi përritjen e ndikimit të fuqive jodemokratike e joliberale, përfshirë Rusinë në këtë rast, e cila, ndër të tjera, synon rritjen e ndikimit në këtë pjesë për t'u shtuar muskujve të saj në arenën globale dhe për ta minimizuar rolin e fuqive demokratike si ShBA e BE. Nga kjo premisë, futja e Dritanit në qeveri pro-serbe kërcënën zhvillimet pro demokracisë e liberalizmit në vend e rajon. Por, edhe politikat dhe qasja e papërgjegjshme e

çorodit ur e Gjukanoviqëve të Ballkanit, që kanë penguar zhvillimin e vlerave demokratike e liberale në këto vende, e vështirëson lidhjen e Ballkanit me botën demokratike e liberale, përderisa mungon zhvillimi i këtyre vlerave në shoqëri që është e domosdoshme për një lidhje të qëndrueshme të vendeve e shoqërive tona me botën demokratike e liberale. Megjithatë, një qeveri por serbe do të ishte edhe më e rrezikshme. Në një vend ku rezultati i përqindjes së forcave në referendumin për pavarësi ishte shumë i ngushtë, e që tregon një qëndrueshmëri jo aq stabile të vet pavarësisë së shtetit, do ta kanoste vetë ekzistencën e Malit të Zi dhe stabilitetin e qëndrueshëm të rajonit. Kjo do të ishte asnjë tjetër përvëçse fitore për Serbinë dhe Rusinë. Qasja parimore e të gjelbërve evropianë dhe e Dritanit e partisë së Dritanit, në Mal të Zi e rajon, për emancipim demokratik e liberal, është e

nevojshme të pasurohet me njojjet për ambicjet geopolitike në rajon të fuqive jodemokratike si Rusia. Anashkalimi i këtij fakti në Mal të Zi e rajon nga të Gjelbrit mund të konsiderohet si naivitet në politikë, i kushtueshëm madje për vetë vlerat që përfaqësojnë të gjelbrit. Fati i demokracive të ish-Republikave Sovjetike në ankthi e vazhdueshëm nga Rusia do të duhej të ishte argument i mjaftueshëm për të gjelbrit evropianë, kur kanë të bëjnë me rastet ku ambicjet ruse janë të përfshira. Kjo nuk do të duhej të merrej si komoditet nga Gjukanoviqi e Gjukanoviqët e Ballkanit, por do të duhej të ishte alarm për ndryshim kursi e qasje, drejt asaj që ishte menduar fillimisht, demokracisë e liberalizmit. Përndryshe, rrezikojmë më shumë se kurrë ta humbasim edhe këtë lloj demokracie ku e mira publike shihet jo më shumë se kumbulla e kopshtit të stërgjyshit të Gjukanoviqëve të Ballkanit.

DO TË BËJ ÇMOS PËR TA MBËSHTETUR KOSOVËN NË RRUGËN E SAJ EVROPIANE



Shkruan: Tomas SZUNYOG


Më ka rënë të trajtoj çështje që kanë të bëjnë me Kosovën që nga viti 1998 dhe kam vizituar Prishtinën disa herë në cilësinë e zyrtarit shtetëror si përfaqësues i vendit tim. Kam mësuar se njerëzit në Kosovë janë shumë të hapur, mikpritës dhe punëtorë. Kam mbërritur në Kosovë në kohët sfiduese të Covid-19, kur shumë njerëz në botë po përjetojnë vështirësi nga aspekti mendor, fizik dhe ekonomik. Qytetarët e Kosovës nuk përbëjnë përjashtim. Ndjej dhembshuri për të gjithë ata që po vuajnë dhe për të afërmit e tyre. Për të korrur sukses në luftën kundër pandemisë është thelbësore që të jemi të përgjegjshëm, ta mbrojmë njëri-tjetrin dhe t'i

ndjekim rekomandimet e autoriteteve. BE-ja tashmë i ka dhënë Kosovës 168 milionë euro për t'i adresuar aspektet shëndetësore dhe shoqërore-ekonomike të pandemisë së Covid-19. Pararendësja ime, ambasadorja Apostolova, ka bërë një punë të shkëlqyer në këtë drejtim. Dua t'ju siguroj që kjo çështje do të mbetet prioriteti im kryesor. Krahas assistencës në lidhje me Covid-19, unë do të vazhdoj t'i promovojoj prioritetet tashmë të vendosura dhe afatgjata të BE-së: arsim më të mirë për të gjithë, më shumë siguri juridike, mbështetje përritjen ekonomike dhe klimë të përmirësuar për investime. Është thelbësore që qytetarët të kenë besim tek institucionet dhe të dinë që përparimi i tyre në jetë është rezultat i punës dhe i meritave të tyre. Unë do të vazhdoj të bëj thirrje përluftë efektive kundër korruptionit dhe krimit të organizuar. Forcimi dhe përmirësimi i procesit zgjedhor gjithashtu duhet të merret si prioritet. Kosova, gjithashtu, duhet t'i përqendrojë më shumë

përpjekjet për çështjet mjedisore. BE-ja po investon 76 milionë euro për ta ulur ndotjen dhe rreziqet ndaj shëndetit nga Termocentrali Kosova B. Rimëkëmbja e gjelbër paraqet një mundësi përritjen e ardhshëm të Kosovës. Një zbatim më i fortë i Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit (MSA), që Kosova ka nënshkruar me BE-në, është në interesin tonë të ndërsjellë. Jam i bindur se sa më shumë që të zbatohet MSA-ja, aq më shumë do të përmirësohet jeta e qytetarëve: standardi i jetesës do të rritet dhe korrupsioni do të ulet. Zbatimi i MSA-së është shansi i madh i Kosovës përrparim. Kosova, gjithashtu, ka nevojë për shërbime më të mira sociale, më shumë barazi gjinore, më pak dhunë në familje, shoqëri më të fortë civile, media më të pavarura, investime në kulturë, dhe më shumë mbështetje dhe bashkëndjenjë përkomunitetet e ndryshme dhe qytetarët nevojtarë. Gjatë 20 vjetëve të fundit BE-ja ka investuar mbi 2.5 miliardë euro në çdo segment të

shoqërisë së Kosovës. Vetëm në periudhën 2014-2019, BE-ja ndihmoi Kosovën me 470 milionë euro, duke mbështetur sundimin e ligjit, të drejtat themelore, mjedisin, energjinë, arsimin, punësimin, konkurrencën, NVM-të, novacionin, bujqësinë, demokracinë dhe qeverisjen. BE-ja është investitori, donatori dhe partneri më i mirë tregtar i Kosovës. Ne kemi krijuar mijëra vende pune, kemi mbështetur qindra kompani dhe kemi ndërtuar shumë shkolla. Falë fondeve të BE-së, Prishtina sot ka furnizim të pandërrerë me ujë të pijshëm dhe dhjetëra mijëra qytetarë gëzojnë ngrohje qendrore të klasës së parë. Unë dua që qytetarët e Kosovës të jenë në gjendje të udhëtojnë pa viza sa më shpejt që të jetë e mundur. Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian kanë thënë që Kosova i ka përbushur të gjitha kushtet dhe kanë rekomanduar heqjen e vizave për Kosovën. Vendimi përfundimtar tanë duhet të merret nga shtetet anëtare të

*Autori është shef i Zyrës së BE-së në Kosovë



GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ

Si u bëra shkrimtar

Shkrim i nobelistit kolumbian, botuar në revistën "New Yorker", në numrin e tetorit të vitit 2003, në rubrikën "Histori personale"

Kurrë nuk e kam marrë me mend se nëntë muaj pasi ta kryeja shkollën e mesme do të më botohej tregimi i parë në *Fin de Semana*, në shtojcën letrare të fundjavës në *El Espectador*, në Bogota, botimi letrar më kërkues dhe më interesanti i kohës. Dyzet e dy ditë më vonë do të botohej edhe tregimi im i dytë. Sidoqoftë, gjëja më besasuese ishte një hyrje e redaktorit të shtojcës, Eduardo Zalamea Borda (emri i të cilit në letra ishte Uliks), kritiku më i mprehtë kolumbian i kohës dhe njeriu që më së shumti i binte në shfaqja e trendëve të rindë.

Mënyra se si rrohdhën gjérat ishte aq e papritur saqë vështirë se mund t'jua sjell qartë. Në shkurt të vitit 1947 u regjistrova në Fakultetin e Drejtësisë në Universidad Nacional të Bogotës. Sikur isha pajtuar me prindërit për këtë fakultet. Jetona mu në qendër të qytetit, në një pensiòn në Calle Florián, që në shumicën e kohës banohej prej studentëve, të cilët, si puna ime, vinim nga Bregu Atlantik. Gjatë pasditeve të lira, në vend se të punoja për t'ia ndihmuar vetes shkollimin, lexoja ose në

dhomën time ose në kafenetë që e lejonin leximin. Lexoja sipas mundësisë ose fatit, çfarëdo që më binte në dorë, dhe në këtë aspekt përzgjedhja e tyre më shumë ishte punë mundësie se fati sepse miqtë që kishin mundësi për t'i blerë, m'i huazonin për një periudhë të kufizuar, kështu që duhej të rrija natën vonë që t'i lexoja me kohë. Ama, ndryshe prej librave që i kisha lexuar në shkollë në Zipaquirá, që i përkisnin mauzoleut të autorëve të shenjtë, këta ishin si buka taze nga shporeti, shtypur në Buenos Aires në përkthime të reja pas boshllékut të madh të botimeve të shkaktuara nga Lufta e Dytë Botërore. Kështu, përfatim tim të mirë, zbulova tashmë të njohurin Jorge Luis Borgesin, D. H. Lawrencen dhe Aldous Huxley, Graham Greenen dhe G. K. Chestertonin, William Irishin dhe Katherine Mansfieldin, si dhe shumë të tjera.

Shumica prej tyre ishin vepra që ishin eksposuar në dritaret e paarrithme të librarive, por disa kopje qarkullonin në kafenetë e studentëve që ishin qendra

aktive të përhapjes kulturore për studentët nga krahinat. Shumë nga këta studentë kishin rezervuar tavolinat e tyre vit pas viti dhe u lihej posta, madje edhe para në kafene. Favoret nga pronarët ose punëtorët e tyre të besueshëm ishin instruktues në shpëtimin e një numri të mirë karrierash universitare dhe goxha do profesionistë në vend u kanë më shumë borxh lidhjeve të tyre në kafene se mentorëve të tyre pothuajse të padukshëm.

Kafeneja ime e preferuar ishte *El Molino*. Ajo frekuentohej prej poetëve më në moshë, që ishte vetëm një dyqind metra ose aty diku *pensiòn* tim, në qoshen e *Avenida Jiménez de Quesada* dhe *Carrera Séptima*. Studentëve nuk u lejohet rezervimi i vendeve në *El Molino*, por ne siguroheshim që të mësonim më shumë nga bisedat letrare që i bënin prej tavolinave të afërtë dhe mësonim larg më shumë se nga tekstet arsimore. Ishte kafene e madhe, elegante, me stil spanjoll. Muret e saj ishin dekoruar prej piktorit Santiago Martínez Delgado me episode nga lufta e Don Kishotit me mullinjtë e erës. Megjithëse nuk kisha vend të rezervuar, gjithnjë merresha vesh me kamerierët që të më bënin vend sa më afër mjeshtrit León de Greiff - mjekrosh, noprani, sharmant, i cili do ta niste *tertulian*, diskutimin e tij letrar, në muzg,

me disa prej shkrimtarëve më të famshëm të kohës dhe e mbaronte me studentët e vet të shahut në mesnatë, i larë në liker të lirë. Kishte pak emra të mëdhenj në artet dhe letrat e vendit që nuk ishin ulur në tavolinë së paku një herë dhe ne bënim veshët katër që të mos na ikte asnjë fjalë e vetme. Megjithëse kishin shprehi të flisnin më shumë për gratë dhe intrigat politike se për artin ose punën, gjithnjë thoshin diçka që ishte e re për ne.

Dhe më kureshtarët prej nesh vinim nga Bregu Atlantik, të bashkuar më pak nga konspiracionet e Karaibeve kundër *Cachacos* - njëzve nga kontinenti - se prej urtësisë së librave. Një ditë prej ditësh Jorge Álvaro Espinoza, student drejtësi që më kishte mësuar leximin e Biblës dhe ma mbushi mendjen t'i mësoja përmendsh emrat e dishepujve të Jobit, e vendosi në tavolinë para meje një libër të madh dhe tha me autoritetin e një peshkopi: "Kjo është Bibla tjetër".

Natyrisht se ishte "Uliksi" i James Joycet, të cilin e lexova, e zhbirova me sytë katër derisa e humba durimin. Kjo ishte njëfarë pjekurie e parakohshme. Vite më vonë, si një njeri i pjekur, e ngarkova veten me detyrën për ta lexuar përsëri, tash më seriozisht, dhe vetëm atëherë zbulova një botë të çiltër që kurrë nuk kisha

besuar se ishte brenda meje, por më dha një ndihmë të paçmuar teknike për ta liruar gjuhën dhe menaxhuar kohën e strukturën në librat e mi.

Një prej cimerëve të mi në *pensiòn* ishte Domingo Manuel Vega, student mjekësie me të cilin ishim miq prej ditëve të djaliqës së qytetën Sucre dhe që ndante me mua pasionin për leximin. Një natë Vega ia behu me tre libra që i kishte blerë dhe ma huazoi njërin, zgjedhur krejtësisht rastësisht, qysh vepronë shpesh, për të më ndihmuar të flija. Por kësaj here, leximi kishte kundërefekt: Më kurrë nuk kam fjetur në qyteti si dikur. Ishte "Metamorfoza" e Franz Kafkës, përkthim i botuar nga Losada in Buenos Aires. Ajo vepër përcaktoi një drejtësim të ri për jetën time prej fjalisë së parë, njohur sot si një prej teknikave më madhështore në letërsinë botërore: "Gregos Samsa, me t'u zgjuar një mëngjes nga èndrrat e sikletshme, e pa veten të transformuar në shtrat në një insekt gjigant".

Këto ishin vepra misterioze, humnerat e rrezikshme të të cilave jo vetëm se nuk ishin ndryshe, por shpesh krejt të kundërtë me gjithçka që kisha ditur deri atëherë. Ato më treguan se nuk ishte e domosdoshme t'i demonstrosh faktet: mjafontë që autoritë shkruante diçka që të kthehej në të vërtetë të mirëqenë,

pa kurfarë dëshmie, pos fuqisë së talentit dhe autoritetit të zërit të tij. Ishte si puna e Shehërzades - jo në botën e saj mijëvjeçare, ku gjithçka është e mundshme, por në një botë të pariparueshme, ku gjithçka tashmë është humbur.

Kur e mbarova leximin e "Metamorfozës" ndieja dëshirë të zjarrtë e të parezistueshme për të jetuar në atë paraqësë të huaj. Të nesërmën e pashë veten në makinën mobile të shkrimit që Domingo Manuel Vega ma kishte huazuar. Isha rrekur të shkruaja diçka që do t'i ngjasonte tregimit të Kafkës, të një burokriti të gjorë të kthyer në një lloj bubureci të madh. Ato ditë nuk shkova fare në universitet ngaqë kisha frikë se do të më këpuntej linja e rrëfimit dhe vazhdova me nakarin e mundimshëm derisa Eduardo Zalamea Borda batoi në faqet e tij një shkrim dëshpërimi duke nxjerrë vrerin shkaku i mungesës së emrave përmbamendje në mesin e brezit të ri të shkrimitarëve kolumbianë dhe faktin se nuk po shihte asnjë shenjë në të ardhmen që do mund t'ia gjente ilaçin kësaj situate. Sot e kësaj dite nuk e di me ç'të drejtë u sfidova, në emër të brezit tim, prej atij shkrimi provokes, por iu ktheva përsëri tregimit me rrekjen që t'ia dëshmoja se e kishte gabim. E përpunova mirë e mirë fabulen e karakterit të ndërgjegjshëm në "Metamorfozë", por e shkarkova rrëfimin prej mistereve të rreme dhe paragjykimeve ontologjike.

Megjithatë, isha aq i pasigurt saqë nuk guxova t'i flisja fare me ndonjërin prej miqve të kafesë në *El Molino*. Madje as me Gonzalo Mallarinson, shokun tim të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, i cili ishte lexuesi i vetëm i prozës time lirike që e shkruaja sa përt ta hequr pak mërzinë prej leksioneve. E rilexova dhe rikorrektova tregimin tim derisa u rraskapita, më në fund ia dola t'i shkruaja një shënim personal Eduardo Zalameas, të cilin kurrë s'e kisha parë, prej të cilit nuk më kutohej as edhe një fjalë e vetme. E futa letër në zarf dhe e dërgova personalisht në *El Espectador*. Portieri më lejoi të njëjtesha në katin e dytë dhe t'ia dorëzoja vetë Zalameas, por u paralizova prej kësaj ideje të pasherr. E lashë zarin në tavolinën e portierit dhe ia mbatha.

Kjo ndodhi në një të martë dhe nuk po merresha me punën e tregimit tim. Isha goxha i sigurt se edhe në rast se do të botohej, nuk do ta shihte shumë shpejt dritën e botimit. Njëherësh, për dy javë me radhë, brodha prej kafenesë në kafene përtë kaluar të shtunën time - drojën e pasdites deri më 13 shtator kur shkova në *El Molino* dhe pashë titullin e tregimit tim të shtypur në gjëresinë e krejt faqes të *El Espectador*, që porsa po më shfaqeja para sys: "Dorëheqja e tretë". Dhe menjëherë m'u këput shpirti kur m'u kujtua se nuk kisha asnjë metelik përt ta blerë gazeten. Ky ishte simbol më shprehimor i mjerimit tim sepse, pos gazetës, shumë gjëra të tjera

elementare kushtonin sa çmimi i saj: trolejbusi, telefon publik, një filxhan kafe, një lustrim këpucësh. U turra në rrugë pa kurfarë mbrojtjeje prej rigës së pandalshme të shiut, por në kafenetë përreth nuk kish njeri që e njihja që do të mund të më jepet ndonjë metelik. Edhe në *pensión* nuk kish njeri në atë kohë të pakohë atë të shtunë, pos bujtinares, e ishte si të mos e gjeje asnjë njeri të vetëm, sepse asaj edhe ashtu i kisha borxh qiranë e dy muajve të kaluar. Kur dola përsëri, i përgatitur përgjithçka, e pashë një njeri të dërguar nga Providencia Hyjnore: ai po dilte nga takzia dhe në dorë mbante *El Espectador* dhe menjëherë i thashë nëse mund të ma dhuronë.

Dhe, ja kështu e lexova tregimin tim të parë të shtypur, me një ilustrim të Hernán Merinos, karikaturisti zyrtar i gazetës. E lexova me një frymë, i struktur në dhomën time, me zemrën që desh po më dilte nga vendi. Në secilin rresht po zbuluja fuqinë dërrmuese të shtypit përtë cilin kisha shkruar me aq dashuri dhe vuajtje derisa imitim i sinqertë të një gjeniu universal po zbuluja si monolog të zbehtë e të mugët, të ndërthurur barfërisht prej tri a katër fjalish ngushëlluese. U desh të kalonin pothuajse edhe njëzet vjet derisa mora guximin ta lexoja përsëri dhe gjykimi im atëherë - i pandikuar prej pasionit - ishte edhe më tolerues.

Halli më i madh ishte mal i shokëve që pushtuan dhomën time me kopje të gazetës dhe me lavdërim përtë një tregim që ishte e sigurt se nuk e kishin kuptuar. Në mesin e shokëve të mi në universitet, disa sosh e pëlqyen, të tjerët ishin mëdyshur prej tij, dhe të tjerët me më shumë racionalitet nuk shkuan as deri te rreshti i katërt, por Gonzalo Mallarino, gjykimin letrar të të cilit nuk ishte punë e lehtë ta vija në mëdyshje, e admiroi tregimin pa asnjë rezervë.

Sikleti im më i madh lidhej me verdiktin e Jorge Álvaro Espinosa, tehu kritik i të cilit ishte i rezikshëm edhe përtë rethit tonë të ngushtë. Kisha ndjenja të përziera: Doja ta takoja menjëherë përtë i davaritur mëdyshjet e mia njëherë e përgjithmonë, por njëherësh më tmerronte ideja e përbolljes me të. Ai nuk u pa deri të martën, që nuk ishte e pazakontë përtë një lexues të pangopur, dhe kur ia behu në *El Molino*, nuk po më fliste përt tregimin, por përgjithmonë.

"Ma merr mendja se e kuptoni se në çfarë telashesh e ke futur veten", tha ai duke m'i ngulur sytë e tij të gjelbër si kobër në të mitë. "Tani je në raftin e shkrimitarëve të njohur dhe duhet të bësh çmos përt ta merituar".

Ishte opinioni i tij ai që mund të ndikonte tek unë po aq sa ai i Uliksit dhe unë që isha shtangur në vend. Por para se ta përfundonte, ndava mendjen t'i paraprija me atë që e konsideroja atëherë dhe që gjithnjë e kam konsideruar, si të vërtetë të

palëkundshme: "Ai tregim është një copë muti".

Ai ma ktheu me një siguri të thashme se nuk mund të thoshte ende asgjë sepse kishte kohë vetëm sa përtia hedhur një sy. Por shpjegoi se, edhe nëse nuk viente përt pesë pare siç pretendoja unë, nuk ishte e mjaftueshme që unë ta sakrifikojë mundësinë e artë që po ma ofronte jeta.

"Sidoqoftë, tregimi tashmë i përket të kaluarës", konkludoi ai. "Me rëndësi tanë është tregimi i radhës".

Në mbeta pa fjalë si torollak, saqë po prisja argumente të kundërtë derisa s'e kuptova se nuk kisha marrë asnjë këshillë më të urtë se e tij. Ai nuk lëkundej prej të vetes, se së pari duhet shkrirë rrëfimin, pastaj të merresh me stilin, porse secili varej prej tjetrit në formën e një shërbimi të ndërsjellët, që ishte shkopi magjik i klasikëve. Ai i kushtoi edhe pak kohë opinionit të tij, që e përsëriste shpesh, se duhej t'i lexoja grekët me mish e me shpirt, dhe jo vetëm Homerin - të vëtmën që e kisha lexuar, sepse më ishte kërkuar përt diplomim. Ia dhashë fjalën se do t'i lexoja dhe doja të dëgjoja emra të tjerë, por ai ndërroi temën dhe nisi të fliste përt *The Counterfeiters* të André Gides që e kishte lexuar në fundjavë. Asnjëherë nuk pata zemër t'i tregojë se muhabeti ynë mund ta ketë përcaktuar rrjedhën e jetës time. Tërë natën nuk e bëra asnjë sy gjumë, duke mbajtur shënimë përt tregimin e radhës, që nuk duhej t'i ngërthente hiletë e të parit.

Një mendje më thoshte se ata që më flisin përt tregimin më pak ishin mahnitur prej vetë tregimit - të cilin, mbase, nuk e kishin lexuar fare dhe po që se e kishin lexuar, nuk e kishin kuptuar - se prej vetë faktit se ishte botuar me një lavdërim të pazakonshëm në një faqe kaq të rëndësishme gazete. Ku dua të dal.

Fillimisht mora vesh se dy të metat e mia të mëdha ishin dy të metat më të mëdha të mundshme: ngathtësia e të shkruarit tim dhe injoranca ime ndaj loçkës së zemrës së njeriut. Dhe, po të dyja ishin fort të dukshme në tregimin tim të parë,

që ishte një meditim konfuz, abstrakt, i përkeqësuar edhe më shumë prej abuzimit të emocioneve të sajuara.

Teksa po gërmajoja thellë përsituata ngajeta reale përt tregimin e dytë, u kujtova se njëra prej grave më të bukura që kisha njohur si fëmijë, më kish treguar se sa shumë dëshironte të ishte brenda maces së këndshme që po e përkëndhelte në prehë. "Sepse, macja është më e bukur se unë". Kjo ishte pika që më shkarkoi prej presionit përt boshtin e tregimit të dytë, si dhe më nxori një titull atraktiv: "Eva brenda maces së saj". Pjesa tjetër, sikurse tregimi i parë, do të sajohet prej hiçit, përtë njëjtën arsy - sikur na pëlgente atyre ditëve të thoshim - ngërthente brenda vates farat e destruktimit të vet.

Ky tregim ishte botuar me të njëjtin lavd si i pari, të shtunën e 25 tetorit 1947, dhe ishte ilustruar prej piktorit Enrique Grau, një yll në ngritje në qellin e Karaibeve. U shtanga kur miqtë e mi e morën këtë si ndodhi të zakonshme dhe mua si shkrimitar të njohur. Unë, në anën tjetër, vuaja sherri i gabileve, dyshoja në suksesin tim, por ia dola mbanë ta mbaja gjallë shpresën time. E mira e të mirave erdhë disa ditë më vonë, kur Eduardo Zalamea, duke përdorur pseudonimin e vet të zakonshëm, Uliks, kisha shkruar një shënim në kolumnen e përditshme në *El Espectador*. I kishte rënë trup: "Lexues të *Fin de Semana*, shtoja letrare e kësaj gazete ka vënë në pah shfaqjen e një talenti të ri dërengim me personalitet të fuqishëm". Dhe shkonte edhe më larg: "Në imagjinatë mund të ndodhë gjithçka, por të dish të tregosh me natyrshmëri, thjeshtësi dhe pa trazim perlën e nxjerrë, nuk është diçka që mund ta arrijnë të gjithë 21-vjeçarët që porsa kanë nisur lidhjen e tyre me letrat". Dhe nxirte përfundimin, pa asnjë hezitim: "Në García Márquez lindi një shkrimitar i ri dhe i shquar".

Ky shënim më nxiti një tronditje lumturie. Si të mos ma sillte! Por, njëherësh, më acaronte se Zalamea nuk kishte lënë asnjë shtegdalje përt arratisje. Tani që kish thënë çfarë kish thënë, shtrëngohesha ta interpretoja

bujarinë e tij si thirrje ndërgjegjes time që nuk do të më ndahej gjatë gjithë jetës.

Pavarësisht bishtnimit tim kronik dhe neglizhencës përt'u kritikuar, e kalova lehtë vitin e parë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë falë mësimit ngutshëm sa përt sy e faqe dhe në provimet më të rënda kalova duke përdorur hiletë e mia të vjetra. T'ju them të drejtë, nuk ndihesha rehat dhe nuk e dija si do të vazhdoja në këtë rrugë pa krye. Fort pak e njihja ligjin, edhe më pak kisha treguar interesim se përt çdo lëndë tjetër gjatë studimeve në *Liceo* dhe mendoja se isha boll i pjekur sa përt t'i marrë vetë vendimet e mia. Shkurt e shqip, pas gjashtëmbëdhjetë muajsh të mbyjetimit tim të mrekullueshëm, krejt çfarë kisha përfituar prej fakultetit ishte një grup miqsh të mirë me të cilët do të kaloja kohë gjatë gjithë jetës.

Interesimi im sipërfaqësor përt drejtësinë ishte edhe më i cekët sesa duket, se e kishte vërejtur edhe Uliksi. Në universitet disa studentë të tjerë nisën të më drejtosheshin me Mjeshtër dhe më prezantonin si shkrimitarë. Kjo rastisi me zellin tim përt mësuar si të thurja një tregim që do të ishte edhe i besueshëm, edhe fantastik por, pa të cara. Kisha një mal me modele të largëta ideale, si "Edipi Mbret" i Sofokliut, protagonisti i të cilët zbardh vrasjen e babait vetëm pasi e merr vesh se ai vetë ishte dorasi; "The Monkey's Paw" të W. W. Jacobit, tregimi i përsosur në të cilin gjithçka që ndodh është aksidentale; "Boule de Suif" të Maupassantit dhe të shumë mëkatarëve të tjerë të mrekullueshëm, dashtë Zoti i ruajtë në mbretërinë e Tij të shenjtë!

Edhe unë u zhyta në një të diele mbrëma kur më në fund edhe mua më ngjau diçka që ia vlen të rrëfëhet. Kisha kaluar pothuajse krejt ditën me nxjerrjen e dufit si shkrimitar me Gonzalo Mallarinson në shtëpinë e tij në Avenida Chile dhe, derisa po ktheshë në *pensión*, dritat e makines ndriçuan njeriun me brirë në stacionin Chapinero. Nuk po gaboj: Thashë një njeri me brirë. Pashë se asnjëri prej pasagjerëve në makinen →



mesnatë nuk u befasua kur e pa njeriun me brirë dhe kjo më bëri të mendoj ai ishte thjesht një prej burrave me kostume që kishte shitur një mori gjérash të dielave në parqet e fëmijëve. Por realiteti ma mbushi mendjen se nuk duhej të kisha dyshime: brirët dhe mjekra e tij ishin të egra si të një dhie, dhe kur më kaloi përskaj, po ia ndieja kundërmimin në gjëzof. Me sjelljet e një kryefamiljari u largua para Calle 26, rruga ku ndodheshin varrezat, dhe u zhdud në mesin e druve në park. Pas gjysmë nate sytë katër prej rrotullimit nëpër shrat, Domingo Manuel Vega më pyeti se çka nuk po shkonte. "Një njeri me brirë hipi në makinë", i thashë, gjysmëfjetur. Ai ishte kthjellur mirë kur ma ktheu nëse përjetova ankth, mund të ketë ndodhur për shkak të telashevë me tretje, tipike për të dielat, por nëse bëhej fjalë për subjektin e tregimit tim të radhës, do të ishte fantastike. Të nesërmën në mëngjes nuk e dija nëse kisha parë një njeri me brirë në makinë ose nëse ishte një halucinacion. Nisa t'ia pranoja vetes se më kishte zënë gjumi, i lodhur në fund të ditës, dhe se pashë një tëndërr që ishte aq e gjallë saqë nuk po mund ta ndaja nga realiteti. Por, në fund, gjëja e domosdoshme për mua nuk ishte nëse njeriu me brirë ishte i vërtetë, porse e përjetova atë përvjojë si të ishte e përmjëmendtë. Dhe për të njëjtën arsy, reale apo të tëndërruar, nuk ishte legitime ta konsideroja këtë si magjepsje e imagjinatës. Ishte, në fakt, një përvojë e hatashme në jetën time.

Tregimin e shkrova të

nesërmën pa lëvizur vendi, e futa nën jastëk dhe e lexova e rilexova disa net me radhë para se të bija në gjumë dhe kur zgjoheshë në mëngjes. Ishte një pëershkrim i fjalëpërfjalshëm i episodit të makinës në rrugë, bash qysh kishte ndodhur dhe me një stil pafajësie si ajo puna e leximit të njoftimeve të thata. Në fund, megithëse s'po më shkoqeshin dyshime të reja, ndava mendjen ta dorëzoja për botim jo në *El Espectador*, por në shtojcën letrare në *El Tiempo*. Mbështetës përmua kjo ishte një mënyrë të përballesha me një gjykim ndryshe prej atij të Eduardo Zalameas dhe të mos e përfshija atë në aventurën të cilën nuk kishte asnjë arsy ta ndante me mua. Tregimin e dërgova me një mik timin nga *pensiōni*, bashkë me një letër për Don Jaime Posadan, redaktorin e ri dhe riosh të *Suplemento Literario* të *El Tiempo*. Por tregimi nuk m'u botua dhe nuk ma ktheu kurkush letrën.

Botimet në *El Espectador*, në margjina të suksesit letrar, më krijuant probleme të tjera larg më mahnitëse. Miqtë e udhëzuar gabimisht më ndalnin në rrugë që të më kërkonin hua që do t'i shpëton sepse nuk mund ta merrnin me mend se një shkrimitar me ngritje kaq të madhe nuk kishte marrë para të majme për tregimet e tij. Pakkush më besoi kur ua tregova të vërtetën troç: Nuk më kisha dhënë asnjëherë asnjë metelik të vetëm për tregimet dhe as që prisja madje, sepse nuk ekzistonte ajo traditë në shtypin e vendit. Madje larg më serioz ishte zhgënjimi i babait kur mori vesh se nuk mund t'i mbuloja as

shpenzimet e mia në kohën kur tre prej njëmbëdhjetë fëmijëve të tij ishin në shkollë. Familja më dërgonte tridhjetë *pesos* në muaj. Vetëm *pensiōni* më kushtonte tetëmbëdhjetë sosh, pa kurrrafë të drejte për të blerë vezë përmëngjes dhe, gjithnjë më duhej të bëja çare me ato para për shpenzimet e paparashikuara. Nuk e di kur kisha nisur shprehinë e bërgjës së skicave në marginin e gazetave, në peceta restorantesh, në tavolinat e mermarta të kafeneve, por një takim i rastësishëm me një të njohur nga *El Molino*, i cili kishte mjaftueshëm ndikim në një ministri për t'u emëruar si skicues, pa pasur edhe idenë më të vogël si vizatohej, propozoi që unë ta bëja punën e tij dhe ne ndanim pagën. Kurrë më në jetë nuk jam përballur më afër me joshjen për t'u korruptuar, por edhe po aq afër sa u pendova.

Interesimi im përmuzikën nisi të ngrivej me kalimin e kohës përdherisa këngët e njohura të Karaibeve - me të cilat isha mësuar qysh në kohën sa isha në gjji të nënës - nisën të depërtionin në Bogota. Programi radiofonik me audiencën më të madhe ishte "Ora Bregdetare", nën nikoqirillëkun e Don Pascual Delvecchios, njëfarë ambasadori i muzikës nga Bregu Atlantik. Emetohej të dielave mëngjesore dhe i doli nami aq shumë saqë ne studentët nga Karaibet shkonim në zyrat e radiostacionit për të vallëzuar deri pasdite vonë. Ai program ishte thelbi i popullaritetit të përmjëhershëm të muzikës sonë në brendësinë e vendit dhe më vonë deri në cepat më të skajshëm; madje studentëve nga bregdeti ua


ofronte mundësinë për ngritje shoqërore në Bogota.

Disavantazhi i vetëm për studentët nga Karaibet në kryeqytet ishte spektri i martesës së detyruar. Nuk e di çfarë precedentësh të ligë kishin fuqizuar bindjen se vajzat në Bogota ishin qepur pas djemve nga bregdeti dhe na sajonin kurthe në shtrat që të na shtrëngonin të martoheshim me to. Dhe këtë nuk e bënin në emër të dashurisë, por ngaqë shpresonin të jetomin me dritare me pamje kah deti. Kurrë s'e kam besuar. Përkundrazi, kujtimet më të parehatshme të jetës time janë ato të bordeleve ogurzeza në periferi të Bogotës, ku ne shkonim ta shtrëdhnim alkoolin. Më i ndryrë prej të gjithëve ishte ai kur një gruamë të cilën porsa isha në shrat, doli lakuriq në korridor, duke më akuzuar me britma se ia kisha vjedhur dymbëdhjetë *pesos* nga sirtari. Dy banditë të shtëpisë publike m'u hodhën sipëri dhe, meqë nuk u kënaqën me zbrazen e xhepave të mi ku m'i gjetën vetëm dy *pesos* që më kishin ngelur pas një seance shkatërruese dashurie, më zhveshën gjithçka, madje m'i hoqën edhe këpucët, për të kërkuar nëse kisha ndonjë para të vjedhur. Ata kishin ndarë mendjen të mos më vrissin, por të më dorëzonin në polici kur gruas iu kujtua se kishte ndërruar dhomën një ditë më parë, ku edhe do t'i gjente paratë qysh i kishte lënë.

Nuk kaloj shumë kohë para se ta ndaja mendjen të mos shkoja më të humbja kohë kot në Fakultetin e Drejtësisë, por nuk kisha guximin për t'u konfrontuar me prindërit njëherë e përgjithmonë. Ata më thanë se ishin shumë të kënaqur me rezultatet e notat e

vitit të parë saqë do të më dërgonin ta blija - nën kujdesin e vëllait tim, Luis Enrique, i cili kishte ardhur në Bogota dhe kishte gjetur punë të mirë në shkurtin e vitit 1948 - makinën më moderne dhe më të lehtë të shkrimit në treg si dhuratë befasuese. Ishte shtypshkronja ime e parë dhe, mbase, më fatkeqja, për shkak se po atë ditë e lamë si garanci për dymbëdhjetë *pesos* me qëllim që ta vazhdonim ndjenjën e mikpritjes me vëllanë dhe me miqtë nga *pensiōni*. Të nesërmën, me kokat që desh po na dilin vendit prej dhimbjes, shkuam në dyqanin e gjërave lënë peng që të siguroheshim se makina e shkrimit ende ishte aty e paprekur dhe se do të mbetej në gjendje të mirë derisa t'ia kthenim paratë që do të na binin nga qilli. Ne kishim një mundësi të mirë pa shfrytëzuar me paratë që skicuesi i trejshëm m'i kishte paguar, por në minutën e fundit ndamë mendjen të mos i kthenim paratë. Sa herë që unë dhe vëllai i binim kah dyqani i gjërave të lëna peng, bashkë ose vetëm, do ta shihnim nga rruga se makina e shkrimit ende ishte aty, mbështjellë si një perlë me letër celofani në mesin e pajisjeve të ndryshme shtëpiake të ruajtura mirë. Pas një muaji, kalkulimet për qejfi që i kishim bërë gjatë euforisë së dehjes tonë ende nuk ishin përbushur, por makina e shkrimit ishte e sigurt dhe e paprekur në vendin e vet dhe do të vazhdonte të ruhej aty derisa të mund ta paguanim normën e interesit katërfish më të lartë se fillestarja.

(Përktheu nga anglishtja:
Rexhep Maloku. Marrë nga revista "Akademia", nr. 8)



GIORDANO BRUNO

BISEDA E FUNDIT

*Biseda e fundit e filozofit
Giordano Bruno me nxënësin e tij
Sagredo, pak para se ta digjin
për së gjalli në furrën e druve*

Përktheu nga italishtja:
Leonora BUÇINCA

Në korridorin e ngushtë, të errët dhe të gjatë të burgjeve të Kastel Sant'Angjelo dëgjohen hapa që shënojnë afrimin e mysafirëve ndaj burrave të dënuar dhe ekzekutimin e radhës.

Me një zhurmë të madhe të çelësave hapet dera e rëndë e qelisë aty ku rri mbyllur i dënuari me djegie në zjarr në furrën e druve: Giordano Bruno. Ai është aty, i shtrirë në kashtë të egër, ndërsa sytë e tij të ndritshëm, të mbajtur dhe të qetë, shkëlqejnë me gëzim dhe butësi në sytë e të ftuarit.

"Sagredo, shoku im i ri!" thërret filozofi i madh.

Të dy përqafohen, kujdestari del i heshtur, pas tij mbyll derën e qelisë së zhveshur dhe të lagur.

"Ti ke rrezikuar, bir. Inkuizicioni nuk ka simpati për ata që kanë simpati për heretikët".

"Maestro, nuk mund të mos ju përshtendesja".

I riu mezi fsheh emocionin e ballafaqimit me mjeshtrin e madh, tanë afër ekzekutimit me një dënim të egër.

"Je bërrë burrë tashmë dhe guximi yt do të të shpërblejë".

"E kërkova nga Kardinal Bellarmino një leje të veçantë. Ai u tregua i mirë. Ndoshita diçka po ndryshon!"

"Po, po ndryshon", konfirmon Bruno "edhe falë vdekjes sime: historia e kësaj bote është e shkruar më shumë me vdekje sesa me jetë. Vdekja njall frikë, shqetësim, pyetje, për më tepër, nëse është ilustruese. Kjo më bën të qetë, shoku im. E di se jam duke përbushur fatin tim".

"Maestro, s'ke frikë nga zjarri që do t'a djegë mishin?"

"Po, Sagredo, kam frikë. Trupi im ka frikë... (refleksion mbi 'trupi im'), por unë e di që nuk do të vdes... kur trupi im fizik të vdes, unë do të jem atje; do ta shoh trupin tim të bjerë, do t'i shoh fytyrat triumfuese, të habitura dhe të mërzitshme të persekutuesve të mi..."

(Pavarësisht prej fjalëve të maestros, fytyra e tij riut është e trishtuar).

"Nëse nuk të kisha lajmëruar... për arrestimin e vajzës dhe të dashurës tuaj, ju nuk do të ktheheshit në Venecia...", thotë ai, pothuajse për ta qortuar veten.

"Do të kthehesha gjithsesi, herët a vonë. Po vdekja e tyre ishte një sinjal përmua..." vazhdon Bruno me shikimin kthyer drejt pafundësisë.

"Me sa butësi e vullnet e kam dashur atë grua... Dashuria, Sagredo, është forca më e madhe e natyrës... është jeta, shkrirja e trupave të të dashuruarve... Afër saj ishte ndjenja e ëmbël e pafundme e shtëpisë, e botës reale, butësia e ëmbël që vetëm një grua inteligente dhe e thellë mund të japë dhe marrë... Sa iluzion, sa injorancë..."

Njeriu s'është i keq, Sagredo. Ai është vetëm i pakënaqur. Mendja e tij e vogël është shkaku i pakënaqësisë së tij. Po, e dija që ato ishin marrë, gjithashtu, për dënimin e tyre. Lajmërimi yt ishte vetëm një konfirmim i trishtuar. Kur trupi im të digjet, unë do të jem i lirë, Sagredo, i lirë të bashkohem me ato, t'i përqafoj. Mos u shqetëso, shoku im... Ky ishte fati ynë i zakonshëm për të gjithë ata që kërkojnë të vërtetën, të dëbuar nga një botë që mbahet me gënjeshtra.

Do të vijë një ditë, Sagredo, kur njeriu do të zgjohet nga harresa dhe, më në fund, do ta kuptojë kush është me të vërtetë dhe kujt i ka dhënë frenat e ekzistencës së tij, për një men-dje të gabuar dhe gënjeshtare që e bën dhe e mban të sklavëruar. Njeriu nuk ka kufij dhe kur një ditë do ta kuptojë këtë, ai do të jetë i lirë edhe këtu në këtë botë".

Kthehet dhe shikon nxënësin e vet gati të ndritshëm.

"Eka parashikuar që nga kohët e lashta jeta..."

"Maestro, po pse ky fat i pamëshirshëm? Kush mund ta këtë dashur gjithë këtë?"

"Unë vetë, Sagredo, shumë kohë para se të lindja në këtë dimension.

Vdekja në zjarr e trupit fizik është një pastrim i thellë. Është pagëzimi i zjarrit. Shumëkush e ka zgjedhur këtë vdekje jo vetëm si shembull për një humanizëm të mpirë, domethënës dhe mizor, por edhe për ta përbushur detyrën që jeta na ka caktuar dhe të cilën e kemi pranuar me dëshirë për dashu-rinë.

Tekefundit, edhe pa vetëdije Kisha po përbush vullnetin tonë".

"Por atëherë... Kardinal Bellarmino bën vullnetin tonë?"

"Bellarmino tani kryen vullnetin e Kishës, që synon ruajtjen e pushtetit. Sidoqoftë, ai, gjithashtu, kryen vullnetin e vërtetë, atë të një vdekjeje ilustruese që lë gjurmë në histori.

Edhe njerëzit e kishave janë pjesë e Një-jes: vdekja ime do të shërbejë për ta treguar fuqinë e vërtetë, fuqinë okulte e cila lëviz prapa të gjitha kishave dhe të



gjitha fuqive të botës.

Në këtë botë ilustruese, ku mbizotërojnë gënjeshtra, mirësia dhe frika hipokrite, një vdekje shembull është më e efektshme sesa një jetë e tërë.

Njerëzit humanë e mbajnë mend. Njeriu që shkakton vdekje është ai që i frikësohet më së shumti vdekjes. Është paradoks-sale, por kush sjell vdekje në mënyrë të dëshpëruar, përpinqet ta kuptojë atë, të depërtojë në mendjen e Zotit".

"Pra, Bellarmino... edhe ai është në kërkim të Zotit?"

"Sigurisht, edhe Bellarmino është një vëlla".

"Maestro, po pse e gjithë kjo!?"

Pse gjithë kjo vuajtje, këto mizori, padrejtësi, dhimbje: vëllezër që vrasin vëllezërit e tyre! Si mund ta firmosë me aq shpirtlehtësi Bellarmino dëni-min e vdekjes tuaj?"

"Ai nuk bëri me aq shpirtlehtësi, Sagredo. Ishte një vendim i dhimbshëm dhe i vuajtur për të, por ai nuk mund të bënte ndryshe.

Ai duhej të hiqte dorë nga veshja që vesh dhe nga besimet që predikon. Ai s'ka vetëdije. Nuk e ndien unitetin e universit të pafund. Nuk e di se veprimi i tij sot do të ketë një reagim për të në jetën e tij të ardhshme, në të ardhmen. Kjo vlen edhe përmua dhe të gjithë ata që janë përpjekur

kot ta zgjognë njerëzimin nga mashtrimi.

Toka është një shkollë e vështirë: çdo veprim lë gjurmë, sepse ekziston drejtësia e vërtetë, bir, edhe pse nuk shfaqet në këtë botë".

"Drejtësia e vërtetë dëshiron vdekjen tuaj?"

"E dëshirojmë vetë, Sagredo, jo trupat tanë kalimtarë, por qeniet e vërteta të pavdekshme që jemi. Na pëlqeu apo jo, ne jemi

shkaku i vetvetes. Qenia nuk i fri-kësohet vdekjes, sepse e di mirë se nuk ekziston. Duke lindur në këtë botë, ne biem në iluzionin e shqisave; besojmë në atë që shfaqet. Injorojmë se jemi të verbër dhe të shurdhër.

Atëherë frika na sulmon dhe harrojmë se jemi hyjnorë, që mund ta ndryshojmë rrjedhën e ngjarjeve, edhe Zodiakun..."

Ne jemi fëmijë të diellit të vetëm të vërtetë që ndriçon botët.

Dhimbja dhe vuajtja nuk ishin aty në fillim të historisë, në kohën e Egjiptit të lashtë i cili akoma ruan kujtesën e origjinës së saj të lavdishme dhe të pavdekshme.

Një ditë, jo shumë larg, një epokë e re më në fund do të vijë në Tokë. Vdekja nuk ekziston. Mjerimi, dhimbja dhe tragje-ditë e saj të shumta janë rezultat i frikës dhe mosdijes për atë që është realiteti i vërtetë".

"Ma, edhe sa kohë duhet?"

"Koha varet edhe nga ne, Sagredo. Koha është intervali mes konceptimit të një ideje dhe manifestimit të saj..."

Njerëzimi konceptoi mikrobin e utopisë dhe gestacioni vazhdon drejt përbushjes së tij të pashmangshme: shekulli i kaluar është një fazë e rëndësishme e cila i paraprin lindjes. Qeniet hyjnore vëzhgojnë gestacionin e Tokës dhe disa kanë lindur këtu për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë se transformimi, gjithashtu, varet nga zgjimi i tyre".

"Edhe ju, maestro, zbritë këtu për këtë qëllim?"

"Edhe unë, Sagredo, por nuk jam vetëm. Ekziston një grup i madh i qenieve që kanë zbritur disa herë përgjatë historisë dhe e njohin veten në të madhin Ermët, Sokrat, Pitagora, Platone, Empedokle..."

Në këtë shekull, Leonardo,

Mikelangjelo, Shekspiri, Kam-pa-nella, emra të njohur, por edhe njerëz të përulur, shërues të thjeshtë, shumë prej të cilëve përfunduan të djegur në kunja".

Giordano mallëngjehet nga kujtimi i shumë personave që i paraprijnë atij në rrugën e témithit.

Giordano vazhdon: "Është pagëzimi i zjarrit që shërben për ta përvetësuar trupin fizik dhe për të manifestuar qenie të vërteta. Zbulesa e tyre tani është e pashmangshme. Nuk e di kur, por e di se shumë prej nesh kanë ardhur në këtë shekull për të zhvilluar arte dhe shkenca, për t'i hedhur farat e kultu-rës së re që do të lulëzojë papritur, pikërisht kur pushteti do të jetë nën iluzionin që ka fituar".

Zhurmat në prapavijë sugjerojnë që vizita duhet të përfun-đojë. Frymëmarrja e Sagredos sa s'ndalet...

"Maestro, si mund të të gjej?"

"Shiko brenda vetes, Sagredo, dëgioje zërin tënd të brend-shëm dhe mbaje mend se maestro i vetëm i vërtetë është qenia që pëshpërit brenda teje. Dëgioje: është e vërteta dhe është brenda teje. Ti je hyjnor. Kurrë mos e harro".

Hapet dera e qelisë dhe paraqitet kujdestari. Duket një fytyrë e një burri të vështirë, por që ka edhe frikë nga ai njeri, burgosësi i të cilit e shëh veten. Ai nuk thotë asnjë fjalë dhe pret me respekt që vizitorit të largohet.

Giordano dhe Sagredo ngrinen dhe përshtendesin njëri-tjetrin, të dy të mallëngjyer.

"Ne nuk po ndahemi Sagredo. Ndaja nuk ekziston. Jemi të gjithë një, në kontakt të përfjetshëm me shpirtin unik..."

(Marrë nga revista "Akademja", nr. 8)

E rrallë

Hapet një vrimë e madhe në Siberi, shkaktar ngrohja globale

Pjesë të metanit të grumbulluar, i cili për një kohë të panjohur kishte qenë nën akullin në Siberi, i cili tani kishte filluar të shkrihej, shpërtheu dhe krijoi një krater mbresëlënës të thellë 50 metra. Shkencëtarët kanë filluar ta hetojnë fenomenin gjersa nuk është bërë tërsisht e ditur nëse kjo humnerë është shkaktuar nga ndryshimi i klimës. Por në vitin 2014 diçka e ngjashme ndodhi në Gadishullin



Jamal në Rusinë veriperëndimore, pas një

serie verash jashtëzakonisht të ngrohta.

FOTO E DITES



Bukuri të rralla nga Kalaja e Petrelës në Shqipëri



DASHI
Tregohuni të kujdes shëm me

fjalët që do të përdorni, pasi mund të përballeni me një konflikt në punë.



DEMI
Dhënia vetes shumë

kohë për t'u menduar, ndonjëherë mund ta vështirësojë zgjedhjen.



BINJAKËT
Ju jeni në një pozitë të shkëlq-yeshme

për t'i ndihmuar disa nga miqtë tuaj sot, edhe pse mund të mos jetë gjëja më e përshtatshme për ju.



GAFORRJA
Një person që doni

shumë do t'ju bëjë vërtet të lumtur, duke ju thënë një gjë që nuk e prisnit.



LUANI
Do të ndiheni shumë

familjar, megjithatë edhe shoqërinë nuk duhet ta lini pas dore.



VIRGJËRESHA
Mos u gënjeni nga sjellja

e mirë e dikujt sepse e bën vetëm për interes. Do t'i përdorni të gjitha energjitet tuaja përfitore.



PESHORJA
Reflektoni mbi një sërë çështjesh të

thëna nga dëkush në veçanti. Do ta kuptioni pak me vonësë domethënien e një të vërtete, por gjithsesi do t'ju pëlqejë.



AKREPI
Vetëm mos e ekzagjeroni

me kujtimet e së shkuarës. Në punë do të merrni rezultate të mira.



SHIGJETARI
Nëse ndiheni i trishtuar

dhe i zhgënyer, duhet të dini se së shpejti do të ndryshojnë ditët tuaja.



BRICJAPI
Ju do të duhet të hiqni dorë nga shumë

gjëra për një qëllim. Do të jetë jashtëzakonisht e rendësishme për disa prej jush që t'i ruani pozitat aktuale.



UJORI
Gjatë kohës së lirë do të

mund të qetësoheni duke lexuar një libër apo duke u marrë me veten.



PESHQIT
Në mëngjes pesimizmi

juaj nuk mund të justifikohet, pasi do t'i nënverherësoni aftësitë tuaja.

BARSOLETA E DITËS



"Jam i shqetësuar sepse ime shoqë kalon mbrëmjet nga një bar te tjetri...", hidhet njëri.
"Mos ka vesin e keq që pi shumë?", e pyet tjetri.

"Jo, jo... Ka vesin që të brendë e të më kërkojë mua".



Në Kino ABC nuk ka shfaqje




E jashtëzakonshme

Burri me thonjtë më të gjatë në botë, kanë gjatësi prej nëntë metrash

Një burrë indian kishte gjatësinë më të madhe të thonjve, prej nëntë metrash, të cilat nuk i preu deri në vitin 2013. Dy vjet më vonë, për t'ia verifikuar gjatësinë, shkuan ta vizitonin

përfaqësues Libri i Rekordeve Gines, shkruajnë mediat e huaja. Thonjtë e tij tashmë janë në një muze në Nju Jork, të cilët po ruhen si monument në shtetin respektiv amerikan.

Rihanna bëri deklaratën e papritur për Chris Brown: Do ta dua gjithmonë



Të gjithëve ju kujtohet ndarja e bujshme e Rihannës me Chris Brownin. Ndarja e tyre erdhi pasi reperi i njohur ushtronte dhunë mbi këngëtaren e famshme. Tani kur kanë kaluar shumë vite nga ngjarjet e hidhura që u bënë kryefjala e mediave, janë lënë pas dhe dyshja ka ndërtuar një marrëdhënie të mirë shoqërore. Rihanna ka dhënë së fundmi një intervistë

ku ka bërë lëmsh rrjetin, pasi u shpreh se mendon se do ta dojë Chrisin gjithmonë. "Ne kemi punuar për të qenë shokë sërisht dhe jemi shokë shumë të ngushtë. Kemi ndërtuar sërisht besim dhe kjo është e gjitha. Ne e duam njëritjetrin dhe besoj se kështu do të jetë gjithmonë. Nuk ka asgjë të cilën përpinqemi ta ndryshojmë", ka treguar ajo.

Dua Lipa zbulon kur e ka dhënë puthjen e parë



Këngëtarja shqiptare Dua Lipa u është përgjigjur 30 pyetjeve në një sfidë interesante për "W Magazine". Ajo ka hipur mbi një dem lëvizës, ndërsa rezistonte dhe u përgjigjej pyetjeve interesante të gazetarit. Dua tregoi se këngëtarët e preferuar nga vitet '90 mbeten grupi i vajzave "Spice Girls", teksha mes Londrës dhe Nju Jorkut, zgjodhi qytetin ku u lind e u rrit, Londrën.

Një nga pyetjet më private të bëra

gjatë intervistës së nxehëtë ishte ajo se kur ka puthur për herë të parë. Këngëtarja shqiptare u përgjigj pa hezitim duke treguar se ka qenë në moshën 17-vjeçare kur dhuroi puthjen e parë. Dua Lipa ka qenë e lidhur për vite me radhë me kuzhinierin dhe modelin e njohur Isaac Carew. Ndërkohë prej më shumë se një viti e gjysmë, ajo ka nisur një lidhje të re me vëllanë e motrave supermodele Gigi dhe Bella Hadid, Anwar Hadid.




Luana Vjollca në kopertinën e revistës së njohur amerikane


"Këngëtare, prezantuese dhe producente, Luana, një luaneshë e vërtetë", kështu e përkruan në titull revista e njohur amerikane "Style Cruze", Luana Vjollcën. Në ditelindjen e saj të 29, autorja dhe moderatorja e "Shiko kush LUAN" është shfaqur në kopertinën e

muajit shtator të revistës së famshme, për të cilën ka dhënë edhe një intervistë ekskluzive. Luana ka zbuluar shumë të pathëna për prestigjiozen amerikane duke përfshirë këtu edhe pikat e saj të dobëta. Ajo ka treguar se është shumë e përkryer në punë.

Covid-19 nuk kurson edhe "bishën" e filmave aksion

Aktorët më i njohur i filmave aksion në botë, Dwayne "The Rock" Johnson dhe familja e tij janë konfirmuar pozitiv me Covid-19. Në një video të postuar në rrjetet sociale aktori bën me dije se, ai, bashkëshortja dhe dy vajzat e vogla, katër dhe dy vjeç, janë konfirmuar të infektuar me koronavirus. Ndër të tjera, ai thekson se ata janë infektuar rreth dy javë më parë dhe fatmirësish janë në gjendje të mirë shëndetësore. Johnson thekson se ato mund të janë infektuar nga kontaktet me miq që nuk e kanë ditur se kanë qenë me Covid.





Përteshi: Bashkimi nuk ndalet, synon sukseset edhe në edicionin e ri

“Përhapja e pandemisë ka ndikuar shumë në buxhetin e klubit, por ne kemi punuar vazhdimisht për t'u organizuar sa më mirë për sezonin e ri. Pra, përkundër izolimit, jemi munduar të punojmë në aspekte të tjera. Gjithashtu, jemi shumë afër bashkëpunimit me disa sponsorë dhe këtë herë presim përkrahje më të madhe nga Komuna e Prizrenit”, ka thënë Përteshi



PRIZREN, 3 SHTATOR - Një nga klubet më të organizuara në konkurrencën e femrave është Bashkimi. Skuadra prizrenase edicionin e kaluar fitoi Kupën dhe Superkupën. Ishte lidere me 14 fitore dhe vetëm një humbje, kur përfundoi stinori i kaluar që, për shkak të pandemisë, u ndërpë.

Kryetari i këtij klubi, Rrahman Përteshi, në një intervistë përfaqen zyrtare të FBK-së ka folur përgjendjen me pandeminë, përforçimet dhe synimet në stinorin e ri. “Përhapja e pandemisë ka ndikuar shumë në buxhetin e klubit, por ne kemi punuar vazhdimisht për t'u organizuar sa më mirë për sezonin e ri. Pra, përkundër izolimit, jemi munduar të punojmë në aspekte të tjera. Gjithashtu, jemi shumë afër bashkëpunimit me disa

sponsorë dhe këtë herë presim përkrahje më të madhe nga Komuna e Prizrenit”, ka thënë Përteshi.

Klubi prizrenas ka vazduar me lojtaret kryesore të edicionit të kaluar, kurse është përfocuar edhe me dy amerikane. “Sa iu përket përfocimeve, mund të them se jemi 90 % në përfundim të kompletimit të ekipe për çdo aspekt. Me përgatitje, lojtaret kanë filluar në mënyrë individuale për shkak se ende nuk kemi leje nga institucionet përkatesë për t'i filluar stërvitje kolektive. Shpresoj që sa më shpejt të na lejohen stërvitjet për shkak se mendoj që jemi të vetmit që ende nuk po stërvitemi dhe jemi të kufizuar në çdo aspekt”, ka shtuar ai.

Në fund ka folur edhe përsynimet për edicionin e ri. “Në lidhje me

ekipin mund të them se kemi lojtaret më të mira vendore në tregun e Kosovës dhe trajnerin (Fabian Gjuka) më të suksesshëm në basketbollin e femrave. Po ashtu, ekipit i kemi shtuar edhe dy amerikane që besoj se do të janë ndihmë e madhe për t'i arritur synimet. Bashkimi synon që të ketë sukseset në sezonin e ri si dhe ta sigurojë pjesëmarrjen në garat e FIBA-s. Natyrish, nuk duhet harruar edhe lojtaret e reja pasi kemi vazduar më të talentuarat që i kemi pasur më herët dhe së fundi i kemi shtuar edhe dy tjera të reja. Krashtë sukseseve, klubit ka politikë edhe zhvillimin e lojtareve të reja për të kontribuar në përgjithësi në ngritjen e nivelit të cilësisë në basketbollin e femrave”, ka përfunduar Përteshi.

Kosova U21, asnjë i infektuar me Covid-19

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës U21 do ta zhvillojë sot (e premte) ndeshjen kundër Anglisë U21 në kuadër të kualifikimeve përvjetore Evropiane 2021. Për gjedhësi Rafet Prekazi përkëndeshje

ka grumbulluar edhe dy futbolistë nga lista paraprake, portierin Ardit Nika dhe mesfushorin Qëndrim Zyba. Lajm i mirë për “dardanët” e rindërtueshë fakti se të gjithë futbollistët dhe stafeti i U21-shave kanë dalë neg-

ativë në testin e kryer përvjetor për Covid-19 nga laboratori i licencuar i UEFA-s dhe tanë janë plotësisht të fokusuar për t'u paraqitur sa më mirë kundër anglezëve. Atmosfera në kampin e “dardanëve” të rindërtueshë shumë e

mirë, edhe entuziazmi dhe dëshira për t'i treguar vlerat e tyre përballë një kombëtareje të madhe si Anglia është e lartë. U21-shat e kanë zhvilluar të enjten stërvitjen e fundit në stadiumin “Fadil Vokri”.



SHKURT

Teuta ia rrëmben kapitenin Tiranës

Erando Karabeci është futbollisti më i ri i Teutës. Ish-kapiteni i Tiranës u prezantua të enjten si lojtari më i ri i fituesve të Kupës dhe Superkupës së Shqipërisë. Me transferimin e Karabecit, Teuta paralajmëron kundërshtaret se do të jetë një ekipe më i fortë se në sezonin e kaluar. “KF Teuta me kënaqësi komunikon arritjen e marrëveshjes me mesfushor Ernado Karabeci. 30-vjeçari ka kaluar me sukses vizitat mjekësore dhe ka firmosur përvjetor. Në Durrës, Karabeci vjen nga Tirana, ku luante prej disa sezonesh në Superligë”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Teutës.

Daku edhe për një vit tjetër pjesë e Ballkanit

Skuadra e Ballkanit ka arritur marrëveshje me Osijekun përvjetor. Klubi portokallezi ka konfirmuar lajmin përmes një postimi në “Facebook”, duke shpresuar se gjilanasi do t'i kthehen formës së vjetër. “Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se pas shumë negociatave me NK Osjek, kemi arritur t'i sigurojmë shërbimet e shtatlartit Mirlind Daku në formë huazimi edhe për një vit. Duke iu referuar thënies se pas dukurive cilësore ngrehet shumë pluhur, ashtu ndodhi edhe me rastin e Dakut, meqenëse negociatat ishin shumë të vështira por, fatmirësish, rezultuan të suksesshme. Nga sulmuesi shtatëtar presim qe të bëjë më të mirën që ai di, pra t'i tundë rrjetat e kundërshtarëve”, thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Rakitiqi prezantohet te Sevilla

Ivan Rakitiqi u prezantua lojtari i ri i Sevillas. Mesfushori kroat është rikthyer te kjo skuadër pas gjashtë vjetësh të kaluarë te Barcelona. Rakitiqi është paraqitur me 200 ndeshje dhe ka fituar tituj me skuadrën e Barçës, kurse me Kroacini ka shkëlqyer në Kupën e Botës. 32-vjeçari në karrierën e vet futbollistike ka luajtur edhe përvjetor për Schalke 04 dhe Baselin.

Ronaldo rrezikon t'i humbasë dy ndeshjet me Portugalinë

Cristiano Ronaldo shqetëson Portugalinë para ndeshjes me Kroacini, e programuar të luhet ditën e shtunë. Sulmuesi ka një problem në një prej gishtave të këmbës së djathët. Të enjten paradite Ronaldo nuk është stërvitur me skuadrën dhe po tenton që përmes antibiotikëve ta largoje infeksionin dhe të mund të luajë në ndeshjen e parë të Ligës së Kombeve. Portugalia e ka edhe një mungesë të sigurt, mesfushor Renato Sanches. Stafi teknik tanë i ka sytë nga Ronaldo dhe shpresohet që të jetë i gatshëm përvjetor takimin kundër Kroacisë, si dhe në përvjetorin me Suedinë të martën.

Më 12 dhjetor zhvillohet dueli Joshua - Pulev

LONDËR, 3 SHTATOR - Sfida e peshave të rëndë në boks mes kampionit në fuqi, britanikut Anthony Joshua dhe bullgarit Kubrat Pulev, do të zhvillohet më 12 dhjetor në stadiumin "O2 Arena" të Londrës. Lajmin e konfirmoi Eddie Hearn,

menaxheri i njohur i boksit, njëkohësisht promotori i Joshuas. Hearn ka thënë se synon ta zhvillojë sfidën në prani të shikuesve edhe pse kjo duket e vështirë, duke parë situatën e krijuar prej pandemisë Covid-19. Gjithsesi, ai mund ta

sigurojë praninë e një numri të limituar fansash për këtë sfidë, ku Joshua do t'i mbrojë titujt IBF, WBA e WBO të peshës së rëndë. "12 dhjetori është data që ne kemi vendosur për këtë sfidë. Ajo do të zhvillohet në 'O2 Arena' të


Londrës. Shpresojmë të kemi të paktën një numër të limituar fansash për këtë duel nëse situa me koronavirus nuk ndryshon", ka thënë Hearn. Për këtë sfidë, një vend që kishte hedhur kandidaturën ishte Kroacia.



Alioski: Kam respekt për Kosovën, por duam kualifikimin me Maqedoninë

SHKUP, 3 SHTATOR - Sulmuesi anësor i Maqedonisë së Veriut, Ezgjan Alioski, ka folur me respekt të madh për Kosovën. Edhe pse ka respekt të madh për Kosovën, ai me Maqedoninë e Veriut synon të kualifikohet në Kampionatin Evropian, që është shtyrë për një vit shkaku i pandemisë. Maqedonia e Veriut do ta presë Kosovën më 8 tetor në Shkup, në ndeshjen gjysmëfinale të "play-off" të edicionit të parë të Ligës së Kombeve. Fituesi i këtij dueli do të luajë në finale më 12 nëntor kundër fituesit të gjysmëfinaleve tjetër ndërmjet Bjellorusisë e Gjeorgjisë për një vend në "Euro 2020".

Alioski, që është lojtar i Leeds Unitedit, ka ndihmuar ekipin e vet që të rikthehet në Ligën Premiere. "Dëshira ka qenë që me Leedsin të ngjitemi në Ligën Premiere, synim të cilin e arritëm dhe tash më mbetet të shkoj në Evropian me Maqedoninë e Veriut. Në ndeshjen kundër Kosovës do ta jap maksimumin nga vetja. Synimi im është që me Maqedoninë e Veriut të arrij



diçka historike, siç është kualifikimi në Evropianin që mbahet vitin tjetër. Kemi gjasa të mira për kualifikim në këtë ngjarje", ka thënë Alioski për "TV Shenja". Alioski është vetëm një nga pesë futbollistët shqiptarë që rregullisht ftohet me Maqedonia e Veriut. Pjesë e ekipit janë edhe Enis Bardhi, Arian Ademi, Visar Musliu e Egzon Bejtullai. "Nuk

duhet të dëgjojmë se çfarë thonë të tjerët. Është ndeshje që duhet disiplinë dhe respekt. I respektojmë, por edhe ata duhet të na respektojnë neve, sepse është vetëm sport, nuk luajmë për politikën që ka ndodhur para shumë vitesh. Edhe Maqedonia e Veriut ka shumë shqiptarë. Nuk ka lidhje se kush do të shkojë në fund në Evropian. Le të shkojë më i miri", ka deklaruar Alioski.

Houstoni kualifikohet në çerekfinale, Miami dyfishon avantazhin

ORLANDO, 3 SHTATOR - Houston Rocketsi bëhet skuadra e fundit që siguron "play-off"-in në NBA, pasi ia doli të triumfojë me rezultatin e ngushtë 104-102 përballë Oklahoma City Thunder dhe të kualifikohet me bilancin e përgjithshëm 4-3. Në "AdventHealth Arena" të Orlando u zhvillua një përballje mjaft spektakolare dhe e luftuar, pasi të dyja skuadrat e kishin të qartë që vetëm njëra do të mund të avanconte më tej, ndërsa në fund fati ishte me Rocketsin, që tani do ta gjejë përballë Los Angeles Lakersin në çerekfinale. Fraksioni i parë dhe i katërt i ndeshjes shuan në favor të City Thunderit, ndonëse me avantazh të lehtë, ndërsa Houstoni fitoi pjesën e dyte dhe të tretë, duke ia dalë ta ruajë edhe kryesimin e rezultatit final.

Kanadezi i Oklahomës, Luguentz Dort, ishte më i miri i ndeshjes me 30 pikë të shënuara, 4 rikuperime dhe një asistim, ndërsa ylli i Houston Rocketsit, James Harden, nuk



arriti ta bëjë diferençën, duke mbetur si rrallëherë me më pak se 20 pikë të realizuara. Pak kilometra më tutje, në "HP Field House" të Orlando, Miami Heat mposhti Milwaukee Bucks, edhe në përballjen e dyte çerekfinale, duke marrë një avantazh 2-0 me ndeshje dhe duke rritur shansonit për të kaluar në gjysmëfinale. Bucks e nisi shumë keq ndeshjen dhe në fund të fraksionit të parë e pa veten në

disavantazh të 9 pikëve, ndërsa më pas provoi reagimin dhe arriti t'i fitojë të tria pjesët e tjera, por pa ia dalë ta përbysë sfidën, që përfundoi me shifrat 114-116. Greku Antetokounmpo dhe amerikanët Middleton ishin më të mirët e ndeshjes, por që nuk ndihmuani dot Milwaukeen ta shmangë humbjen, ndërsa te Miami Heat spikati sërisht ylli slloven i skuadrës Goran Dragić.

SHKURT

18 futbollistë me koronavirus te Boca Juniors

Boca Juniorsi ka konfirmuar se 18 lojtarë të ekpit janë të infektuar me koronavirus, 15 ditë përpëra nisjes së Kupës Libertadores. Klubi argentinës e dha lajmin pas testeve të kryera te të gjithë lojtarët dhe stafi teknik. "Të gjithë do të izolohen siç thotë protokolli dhe do t'u nënshtrohen testeve të tjera përpëra se ta rinisin stërvitjen", thuhet në njoftimin e klubit argentinas. Boca Juniorsi nisi stërvitjen në një "fluskë" për t'u përgatitur për nisjen e sezonit të ri, por ky infektim masiv ka bërë që klubi të hetojë përsyjet e shpërthimit të Covid-19 mes lojtarëve.

Pochettino: Messi mund të shkëlqejë në Premierë Ligë

Ish-trajneri i Tottenham Hotspurit, Mauricio Pochettino, ka thënë se Lionel Messi do të ishte më i miri në secilën ligë, përfshirë edhe Premierë Ligën. Messi i ka bërë me dije Barcelonës se dëshiron të largohet këtë verë. "Gjithçka mund të ndodhë. Messi mund të luajë kudo që ai dëshiron, në Spanjë apo Premierë Ligë. Ai është gati të bëhet më i miri në secilën ligë", ka thënë Pochettino.

United transferon Van de Beekun

Mesfushori Donny van de Beek edhe zyrtarisht është futbollist i ri i Manchester Unitedit. "Manchester United është i lumtur ta konfirmojë ardhjen e Donny van de Beek nga Ajaxi. Holandezi ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare, me mundësinë për të vazhduar edhe për një vit tjetër", thuhet në njoftimin e Unitedit. Raportohet se për shërbimet e 23-vjeçarit Unitedi ka paguar 39 milionë euro, plus 5 milionë euro të tjera bonuse.

Smallingu, drejt rikthimit te Roma

Qëndrimi i Chris Smalling te Manchester Unitedi duket se do të jetë i shkurtër. 30-vjeçari pritet të rikthehet sërisht në Itali te skuadra e Romës, ku sezoni e kaluar luajti në formë huazimi. Drejtuesit e verdhekuqve kanë nisur bisedimet me "djatjtë e kuq", të cilët kanë marrë miratimin nga trajneri i tyre Solskjaer për ta shitur futbollistik, pasi ai kërkon ta afrojë në skuadër qendërbrojtësin e Leipzigut, Upamecano. Këtë herë klubia nga kryeqyteti italian dëshiron ta blejë përfundimisht futbollistik, për të cilin ekipi nga "Old Trafford" kërkon 20 milionë euro, plus 5 milionë euro bonuse.

Werner: Duam të rivalizojmë me Cityn dhe Liverpoolin

Sulmuesi Timo Werner ka thënë se me skuadrën e tij të re, Chelsea, do të rivalizojnë me Manchester Cityn dhe Liverpoolin për titullin e kampionit në Premierë Ligë. Sulmuesi gjerman u transferua në "Stamford Bridge" nga Lajpcigu për 53 milionë paund gjatë kësaj vere. "Është diçka e shkëlqyer të punosh me Lampardin dhe kemi diskutuar planet për të ardhmen dhe se si duam të luftojmë me skuadra si City dhe Liverpool. Mendoj se Chelsea është një klub i madh dhe me këtë skuadër mund ta arrijmë nivelin tjetër", ka thënë Werner.

 REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE GLAVNI CENTAR PORODIČNU MEDICINU MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE No: 831/020 Data: 01.09.2020 SKENDERAJ	 Kuvendi i Komunës Skenderaj Skupština Opštine Skenderaj Municipal Assembly Skenderaj
<p>Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje Department of Health and Social Welfare</p> <p>Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Nr. 831/020 Skenderaj 01.09.2020</p> <p>Në bazë të Vendimit të Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Skenderaj nr.08-111/01-0037364/20 të datës 28.08.2020 për lejimin e shpalljes së konkursit përvendet e lira të punës për nevojat e QKMF-së në Skenderaj e në përpjthje me nenin 7,8,10 parg 1 nënparagrafi 2.1, nenit 15 paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, nenit 4 i Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, QKMF në Skenderaj publikon këtë :</p> <p style="text-align: center;">KONKURS PËR PRANIM NË MARREDHËNIE PUNE</p> <p>I. Titulli i vendit të punës : Teknik/e i/c Farmacisë një (1) pozitë (zëvendsim deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë)</p> <p>Kategorija dhe grada e vendit të punës: Koeficienti : (4.80) H-377 , H-70 Orari i punës 40 orë në javë Kohëzgjatja e Kontratës sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212</p> <p>Përshkrimi i detyrave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryen të gjitha punët dhe detyrat e Teknikut të Farmacisë. - Kontrollon gjendjen gjatë pranimit të materialit në barnatore ku punon. - Respektimin e të drejtave të shfrytezuesve të shërbimeve shëndetësore. - Mbajtjen e dokumentacionit të Teknikut të Farmacisë-Infermierisë, në atë mënyrë që të mos demtoi imazhin e Institucionit ku punon. - Bënë ndarjen e barërave sipas reçetave. - I udhëzon pacientet për përdorimin e drejtë të barërave (si duhet të përdoren) dhe duhet të këtë sjellje korrekte ndaj tyre. - Jep edhe informata tjera mbi mënyren e përdorimit të barërave. - Bënë rregullimin logjik të barërave dhe rregullimin e tyre sipas datës së skadimit. - Bënë rregullimin etiketave të rastave, dhe rregullimin e kartelave të barërave . - Kujdeset për higjenën e ambientit ku punon dhe respekton orarin e punës. - I kryen të gjitha shërbimet tjera në lëmin përkatës. - Kryen edhe punë tjera sipas Urdherit të Drejtlorit, Zv.Drejtlorit dhc statif tjetër Udhëheqes të QKMF-së, para të cilëve për punën e vet i'u përgjigjet. - Detajet e tjera të detyrave dhe përgjegjësive do të përshruhen në kontratën e punës. <p>Kushtet e Konkursit :Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këto pozita përvëq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligji duhet të kenë të përfunduar :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkollën e Mesme të Mjekësisë-Teknik/e i/c Farmacisë - Licencën e punës . <p>Dokumentet e kërkua :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kopja e Diplomës së Shkollës së Mesme të Mjekësisë - Teknik/e i/c Farmacisë - Kopjen e Licencës së Punës - Certifikatën e Lindjes - Kopjen e letërnjoftimit - Certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime - Çdo dokument tjeter apo certifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriteret e përcaktuara më lartë. - Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter –e deshirueshme. <p>Çdo aplikues duhet te plotësoi dhe derëzoi dokumentacionin me sa vijon :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fletë aplikacionin e plotësuar - Dokumentacionin mbi përgatitjen dhe kualifikimin profesional/kopje/ e noterizuar. <p>Të gjithë kandidatet të cilët hyjnë në listën e ngushtë, do të fitohen në intervistë, dhe për datën e mbajtjes së intervistës do të njofohen me kohë dhe do të intervistohen nga Komisioni Intervistues .</p> <p>Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në administratën e QKMF-së Skenderaj nga ora 08:00 deri në ora 15:00.</p> <p>Dokumentacioni i cili nuk ju përgjigjet kërkeseve dhe specifikave të Konkursit si dhe dokumentacioni i pa komplektuar dhe ai që arrinë me vonësë , nuk do të shqyrtohen.</p> <p>Të drejtë për aplikim kanë të gjithë Shtetasit e Republikës së Kosovës</p> <p>Afat për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes publike në Gazetë Ditore dhe mjete tjera të informimit.</p> <p style="text-align: center;"> QKMF Skenderaj Administrativa </p>	

 REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE GLAVNI CENTAR PORODIČNU MEDICINU MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE No: 831/020 Data: 01.09.2020 SKENDERAJ	 Komuna Skenderaj Republik of Kosovo Municipality Skenderaj
<p>Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje Departmen of Health and Social Welfare</p> <p>Glavni Centar za Porodicnu Medicinu Br. 831/020 Skenderaj, dt. 01.09.2020 god.</p> <p>Na osnovu direktora direkcije za zdravstvo i socijalno blagostanje br. 08/11/01-0037364/20, od dana 28.08.2020 god., za odobrenje objavljuvanje konkursa za slobodna radna mesta , u okviru GCPM-a Skenderaj/Srbica i u skladu sa članom 7,8,10 ,stav 1, podstav 2.1, čla 15 stav 1,2 i 3 Zakona o Radu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Upustva MRSZ br. 07/2017, za regulisanje procedura konkursa u javnom sektoru, u GCPM-u Skenderaj/Srbici objavljuje sledeći:</p> <p style="text-align: center;">KONKURS ZA PRIJEM U RADNOM ODNOSU</p> <p>Naziv radnog mesta: Tehničar Pharamacie, jedan (1) položaj</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategorija stepen radnog mesta: - Koeficijent 4.80, H-$\frac{1}{4}$ - Radno vreme 40 časova nedeljno; - Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212 <p>Opis Radnih Zadataka:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Izvršava sve poslove tehničara Farmacije; - Kontrolira stanje u toku prijema lekova u apoteku gde radi; - Poštovanje prava korisnika i zdravstvenih usluga; - Održavanje dokumentacije tehničara farmacije-Infermierstva, tako da ne nanosi štetu autoritetu institucije gde radi; - Daje lekove prema lekarskom upistvu; - Vodi paciente za pravno upotrebu lekova (kako upotrebiti) i treba korektno ponašanje prema njima; - Daje i druge informacije za način upotrebe lekova; - Izvršava reguliranje etiketa na rastvorima i reguliranje kartica lekova; - Stara se za hijajenu prostorije gde radi i poštuje radno vreme; - Izvrši sve poslove od dotične oblasti; - Izvršava e i duge poslove po naredenju direktora; z.direktora i drugog rukovodilačkog osoblja GCPM-a, kojima reportira za svoj rad; - Drugi detalji zadataka i obaveza ce se opisati u radnom ugovoru. <p>Uslovi konkursa:</p> <p>Kandidati/kinje koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslovi predvidenih prema zakonu mora imati završen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Medicinsku Srednju Školu Tehničar Farmacije ; - Kopije licence za rad; <p>Potrebna dokumentacija:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kopiju Diplome Pravnog Fakulteta (overena od notara); - Rodjeni izvod; - Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova; - Dokaz o radnom iskustvu; - Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda - Svaki drugi dokumenat od raznih trajnega, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto, trebaju priložiti dokumentaciji; - Kandidat koji se prima na posao mora doneti i Lekarsko uverenje; - Dokaz o osnovnom poznavanju rada u računaru. <p>Svaki aplikant mora predati svu traženu dokumentaciju prema konkursu i to:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punjenu aplikaciju; - Dokaz o stručnoj spremi i profesionlanoj kvalifikaciji/kopije/ overena o beležniku; <p>Svih kandidati koji udu u užu listu, ce se pozvati na intervju, i za datum održavanja intervijua biće na vreme obavešteni od strane određene Komisije za Interviju.</p> <p>Aplikacioni se mogu dotibi prazne i popunjavaju se i predaju se u Administraciju GCPM-a Skenderaj/Srbica od 8-15 časova.</p> <p>Dokumentacija koja se priloži aplikaciji mora biti fotokopije i ista se ne vraća kandidatu.</p> <p>Dokumentacija koja se ne odgovara uslovima i kriteri konkursa , kao i nekompletirana dokumentacija i ona koji dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati.</p> <p>Rok za konkursanja ce biti petnaest (15) dana od dana objavljuvanja konkursa u dnevnom novinu i drugim sredstvima informiranja.</p> <p>Konkurs se objavlja u oba jezika.</p> <p style="text-align: right;"> GCPM Skenderaj Administracija </p>	

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT SWISS TAVERNA PRISHTINË

Tel: +377 45 400 156 | +386 49 848 553

- >> SHPALLJE TË VOGLA <<**
- Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**
- "Tribuna Media Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. të regjistrimit: 71110257 dhe numër fiskal: 601183403.
- Ardian Halili shpall të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit Ekonomik në UP me nr. 40501110010
- Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m² e mobiluar me nxehje qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.
- Jap banesë me qira afër 60 m², katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërrloq, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banës me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banës me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banës me qira garsoniere në Ulpian katër i parë, posedon tre shtëpier dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katër i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përbanim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentishit kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katër i tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershorë deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër të prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajiset. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme përbanim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afér AAK-së. Banesa është e mobiluar komplekt. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, katër i l-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi përbanim 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



Royal Crown RC Cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC Cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905

RC Cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L